



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC

Drejtoria për Administratë të përgjithshme

Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Orahovac



1

PROCESVERBALI

Nr. prot. 1768 Më 30.05.2018
Dt. 30.05.2018
RAHOVEC - ORAHOVAC

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më 30.04.2018 me fillim në ora 10.15. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. **Afrim Dina**. Konstatohet se kuorum për mbajtjen e mbledhjes kemi, **Kryesuesi** – Fillimisht më lejoni të përshëndes Kryetarin e Komunës z. Smajl Latifi, Nënkryetarin e Komunës z. Fatmir Iska, përfaqësuesit e LMT-së, monitoruesit e OSBE-së, monitoruesit e SHL- Kosova, përfaqësuesit e mediave, Drejtorët e Drejtorive Komunale, delegatët e Kuvendit Komunal dhe gjithë të pranishmit. Besoj se rendin e ditës dhe materialin e kemi marrë me kohë? Për këtë mbledhje propozoj këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e këshilltarëve,
3. Shqyrtimi i Raportit 3 mujor financiar të vitit 2018,
4. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të brendshëm për DKA-në
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike – Stacioni i Autobusëve,
6. Shqyrtimi dhe aprovimi i dhënies së pronës së paluajtshme Komunale në shfrytëzim afatshkurtër personave fizik dhe juridik,
7. Shqyrtimi dhe aprovimi i marrjes së vendimit për ndarjen e mjeteve për Festivalin Folklorik Kombëtar “Anadrinia Jehon” Dejnë.

Bajram Morina - Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, materiali për këtë mbledhje mua nuk më ka ardhur.

Kryesuesi – Besoj se në email materialin ju ka ardhur të gjithëve, po ashtu nga sekretaria e Kuvendit u njoftova se materiali është dorëzuar në zyrën e fshatit Ratkoc, por besoj se kjo do të jetë hera e fundit, ne do të gjejmë formën dhe mundësin për të ju sjellë materialin fizikisht në shtëpitë e juaja. Para se të ja fillojmë me rendin e ditës a ka dikush nga këshilltarët që të arsyetojë mungesën nga mbledhjen e kaluar.

Shqipe Kryeziu – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, arsyeja pse nuk kam qenë në mbledhjen e kaluar është sepse kam pasur rast vdekje.

Artan Zenuni – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, arsyeja pse nuk kam qenë në mbledhjen e kaluar është sepse kam qenë për vizitë shëndetësore jashtë vendit.

Kryesuesi - Të nderuar Kuvendarë desha të ju njoftoj se vendimet nga mbledhja e kaluar na janë kthyer nga MAPL-ja pozitive. Po ashtu i falënderoj Kuvendarët që na kanë sjellë të gjitha fotot e tyre, por ju kisha lutur që brenda dy javëve të na dërgoni edhe CV-të tuaja.

E qes në aprovim rendin e ditës: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës.

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

A ka dikush të shtoj ose ndonjë vërejtje sa i përket Procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Fehmi Cena – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë, është bërë një gabim teknik tek diskutimi në faqe 8 dhe 12, kishte me qenë mirë nëse i përmirësoni këto gabime teknike.

Kryesuesi – E qes në aprovim Pikën e parë të rendit të ditës: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e parë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e këshilltarëve.

Pyetjet që i keni parashtruar në mbledhjen e kaluar përgjigjet i keni marrë të gjithë.

Vahid Krasniqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, 3 pyetje të cilat i kam parashtruar në mbledhjen e kaluar nuk më është kthyer asnjë përgjigje, as përmes email adrese e as fizikisht. Sa i përket pikës së dytë tani do parashtroj një pyetje, është bërë një kërkesë nga Kryetari i fshatit me datë 21.02.2018 në Drejtorin e Urbanizimit për një parcelë, parcela e ka nr.2267 ku përfshihen 3 hektar tokë dhe shfrytëzues i kësaj parcele është Agjensioni i pyjeve të Kosovës. Desha të di se deri ku ka arritur ecuria e kësaj kërkesë dhe deri ku kemi mbërritur me procedura, sepse ne jemi duke shpresuar pasi të rregullohet puna e kësaj parcele të përfitojmë ndonjë donacion.

Rexhep Oruqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, unë kam për ti ngritur dy çështje: E para është për furnizim me ujë të pijes për qytetin e Rahovecit, ka vërejtje nga qytetarët se që nga data 1 Prill 2018 ka ndërprerje të furnizimit me ujë të pijes në pjesën e vjetër të qytetit, nga qendra e qytetit, rasat e Rahovecit, lagja e Kreishtës, lagjja e romëve dhe ashkalive, po ashtu edhe në lagjen e komunitetit serb. Është e logjikshme që të ketë reduktime në muajin korrik dhe gushtë, por në muajin prill të mos ketë ujë të pijes mjaftueshëm më duket se është jo seriozitet nga ana e ndërmarrjes KRU-Radoniqi. I bëj apel Kryetarit të Komunës, Drejtorit të Shërbimeve Publike që të ju drejtohet kompanisë KRU- Radoniqi pse nuk ka ujë të pijes. Kam një informatë se një punëtor i KRU- Radoniqit i cili është përgjegjës për të i lëshuar pompat ai nuk shkon fare në ndrim të natës rin dhe flenë në shtëpi, mendoj se nuk është e përgjegjshme që gjysma e qytetit të Rahovecit me vuajt për ujë të pijes për shkak të neglizhencës së një zyrtari të kësaj kompanie. Çështja e dytë që dua të ngrisë është se me datë 06.05.2018 fshati Dejnë tani e ka edhe tradicionalisht dhurimin humanitar të gjakut, këtë vit është duke u bërë si aktivitet ndërkombëtar ku do të marrin pjesë edhe nga shtetet fqinje si Shqipëria, Maqedonia, Mali i zi, kishte me qenë mirë mendoj që simbolikisht Komuna e Rahovecit të i dele në ndihmë edhe pse kërkesë me shkrim nuk ka, por po e them pasi është e karakterit kombëtar kishte me qenë mirë që të ketë një solidaritet nga Komuna.

Masar Popaj – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, kam një pyetje në lidhje me arsimin në Komunën tonë pasi që jam edhe Kryetar i Këshillit Drejtues të shkollës së mesme e ulët "LIRIA" Fortesë. Më ka rënë në sy infrastruktura e objektit të shkollës si dyert e shkatërruara, dritaret, banket e thyera, karikat etj, me të vërtetë është në një gjendje aspak të mirë shkolla e fshatit tim, në një mbledhje të organizuar nga Këshilli Komunal i prindërve të Komunës sonë ku edhe unë kam qenë pjesëmarrës, në këtë mbledhje ka pasur vërejtje mjaftë të mëdha sa i përket kushteve nëpër shkollat tona p.sh, mungesa e nxemjeve qendrore, mungesa e pajisjeve elektrike, ndriçimi i klasave jo në nivel, mungesa e ujit nëpër tualete, papastërti, mungesa e bankave, karrikave, mungesa e materialit harxhues etj, mos të flasim për laboratorë që shkollave tona i mungojnë. Pyetja ime është për qeverinë komunale a i kanë vizituar këto shkolla dhe nëse po kur pritet që të ndërmerr masat për investime të nevojshme në infrastrukturë dhe në zgjidhjen e dukurive të tjera që shfaqen nëpër shkollat tona. Do të flasë më shumë për gjendjen e shkollës në Fortesë sepse me të vërtetë kjo shkollë është në një gjendje të mjerueshme, nuk e di a e kanë vizituar inspektorati këtë shkollë sepse për mendimin tim aty nuk ka kushte për zhvillim normal të procesit mësimor, pyetje ime për kryetarin është: I nderuar Kryetar çka do të bëhet me këtë objekt të shkollës. Mendimi imë është se aty duhet që të ndërtohet një shkollë e re sepse ky objekt nuk i plotëson as kushtet elementare për zhvillim të një procesi të rregullt mësimor, ky objekt është i ndërtuar para 48 viteve.

Hanalora Hoti – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, çështjen për të cilën dua të flas unë i adresohet Drejtorisë për Shërbime Publike. Projekti i kubëzimit të rrugës në Ana-Drini në fshatin Ratkoc është shqetësim që vije nga banorët e asaj lagje, ky ishte premtim edhe nga qeverisja e juaj e kaluar por edhe së fundmi nga qeverisja që e lëmë pas, të gjitha matjet për këtë rrugë kanë përfunduar dhe sa e di ky projekt është në listën e kontratave, por ajo që dua ta di është se kur do të filloj realizimi i këtij projekti. Shqetësimi tjetër është se në hyrje të fshatit është duke u bërë hedhja e mbeturinave nga njerëz të papërgjegjshëm, konkretisht tek pjesa të

cilën e quajmë Ledina e Harrimit, në këtë pjesë është duke u grumbulluar mbeturinat edhe nga fshatrat përreth si Vrajak dhe Bratotin, e dimë që në funksion është kompania për mbledhjen e mbeturinave por cila kishin me qen masat mbrojtëse për këtë dukuri aktuale që është duke ndodhur në atë pjesë.

Mirjeta Krasniqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, kisha pas dëshirë të ndërlidhem në këtë pikë pasi kemi shqetësime nga banorët e fshatit Pastasel, gjendja e shkollës në këtë fshat është në një gjendje të mjerueshme ku e keni parë dhe vetë i nderuari Kryetar, pyetje ime për Kryetarin dhe drejtorin e DKA-së është: A e keni paraparë për vitin në vijim ndonjë kod buxhetor për rregullimin ose meremetimin apo ndërtimin e një shkolle të re. Po ashtu i nderuari Kryetar a keni paraparë mjete për kubëzimin ose rregullimin e ndonjë rruge të fshatit Pastasel sepse gjendja e rrugëve në këtë fshat është e mjerueshme, mendoj se duhet që të fillohet të punohet nga aty ku gjendja është më e rëndë pra atyre të ju jepet së pari prioritet.

Refki Kryeziu – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, desha të parashtoj një pyetje Drejtorit të Bujqësisë, pyetja ime ka të bëjë rreth projektit të kullimit të tokave bujqësore përë fshatin Xërxë me kodin 45777, për të cilin kod janë paraparë mjetet për këtë vit nga niveli qendrorë 30,000.00 € dhe niveli lokal 20,000.00 €. A keni ndërmarrë diçka rreth këtij projekti sepse është shqetësuese për banorët e fshatit Xërxë dhe Fortesë ku përfshihen në këtë zonë diku 150 hektar tokë. Mos finalizimi i këtij projekti, të gjitha ato toka që gjenden përball kompanisë M-Silloi në fshatin Xërxë çdo vit janë duke u përfshirë nga uji nga të reshurat atmosferike gjë që ju pamundëson banorëve të kësaj ane të punojnë tokat e tyre. Po ashtu e kam edhe një pyetje për Drejtorin e Shërbimeve Publike, Në kuadër të financimit të investimeve kapitale Komunale ekziston kodi buxhetor 40814 për infrastrukturë publike 2018 – 2020 në ndriçim publik, ku në vitin 2018 parashihen investime diku 120,000.00 € , 100,000.00 € nga niveli qendrorë dhe 20,000.00 € nga niveli lokal, kurse deri në vitin 2020 parashihen investime në ndriçimin publik kurse në rrjetin ekzistues diku 585,000.00 €. Është shumë shqetësuese për banorët e fshatit Xërxë si bashkësi lokale sekondare sikurse janë fshatrat Ratkoc dhe Krushë e Madhe të cilët kanë ndriçim publik kurse fshati Xërxë ende mbetet pa ndriçim publik. Ndriçim publik në Komunën tonë kanë edhe disa fshatrat të cilat nuk janë bashkësi lokale, gjë që është shumë mirë që e kanë dhe duhet të gjitha fshatrat e Komunës ta kenë. Në fshatin Xërxë e dini që veprojnë shumë biznese duke filluar nga Ura e Shenjtë e deri në Rugovë të Hasit, ku kriteret e vlerësimit të bazë tatimore janë të zonës së parë. Investimi i Komunës në ndriçimin publikë në fshatin Xërxë do të jetë një siguri më e madhe për qytetarët tanë dhe për bizneset që operojnë në këtë fshat, të cilët pothuajse çdo vit ballafaqohen me thyerje, plaçkitje të bizneseve të tyre nga personat e papërgjegjshëm. Pyetje ime për ekzekutivin është: A keni ndonjë plan konkret për ndriçimin publik për fshatin Xërxë, kishte me qen mirë që këtë shqetësim ta ketë parasysh edhe Kryetari i nderuar, Kryesuesi i Kuvendit, KPF-ja, po ashtu propozoj që kjo të caktohet edhe si pikë e rendit të ditës për mbledhje të ardhshme, gjithashtu kisha kërkuar nga kolegët e mijë Kuvendarë që ta përkrahin këtë pikë.

Shqipe Kryeziu – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, desha të ndërlidhem me fjalimin e z. Masar Popaj, ku gjithashtu edhe pyetje ime i drejtohet Drejtorit të DKA-së. I nderuar shkolla “LIRIJA” në Fortesë ka qen e përzgjedhur nga MZHE për projektin e efijencës së energjisë, gjendja e shkollës është vlerësuar kurse punimet është dashur të ja fillojnë tani. Dua ta di se çka ka ndodhur me këtë projekt sepse ka zëra që ky projekt është bartur në shkollën “Vëllezërit Frashëri” në Drenoc, nëse është e vërtet pyetje ime është: A është marrë pëlqimi nga komuniteti i fshatit Fortesë për bartje të këtij projekti.

Afrim Berisha – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, sot dua që ti ngrisë dy çështje për të cilat mendoj se janë shumë të rëndësishme për qytetarët e Komunës së Rahovecit, e sidomos për ata që vinë nga ana e Gradishit e deri në Kramovik. Njëra ka të bëjë me fushën e kulturës the Festivalit Folklorik “Anadrinia Jehon” dhe tjetra me varrezat e banorëve të besimit katolik në fshatin Dobidol. Nisur nga fakti se festivali “Anadrinia Jehon” i cili mbahet në fshatin Dejnë tash më ka marrë karakter Kombëtar ku marrin pjesë grupe nga mbarë trojet shqiptare dhe bazuar nga përvoja e organizimit nga vitet e kaluara dhe në ruajtjen e trashëgimisë kulturore dua ta di se ky festival i rëndësishëm a është i përfshirë në Statutin e Komunës së Rahovecit si festë zyrtare, nëse jo atëherë kisha kërkuar nga ju i nderuari Kryetar, nga Kryesuesi dhe ju koleg të nderuar që kjo ngjarje kulturore të hyjë në listën e ftesave zyrtare të Komunës së Rahovecit. Në fshatin Dobidol të Komunës së Rahovecit jetojnë disa

familje të besimit Katolik gjatë bisedës me ta mu kanë adresuar që ta ngris një çështje shumë të rëndësishme për ta. Ata kanë probleme infrastrukturore me rrugën që shkon deri tek varrezat e tyre. Këta banorë të besimit katolik, gjatë ceremonisë së varrimit të afërmeve të tyre për shkak të kushteve të tyre të dobëta të rrugës që janë aty, shpesh herë detyrohen që të afërmit e tyre ti varrosin në varrezat e fshatit Doblibare, i cili fshat është nën administrimin e Komunës së Gjakovës. Prandaj kërkoj nga ju që ky shqetësim i këtyre banorëve të merret seriozisht dhe në një të ardhme të afërt të planifikohet rregullimi i kësaj rruge deri tek varrezat.

Flori Boshnjaku – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, desha edhe unë të ndërlidhem sa i përket pyetjeve, mendoj se shqetësimet e qytetarëve janë shumë me rëndësi, pyetje ime i drejtohet Drejtorisë për Shëndetësi, është një shqetësim i qytetarëve sa i përket rriqave ky problem është i gjithë komunës dhe i gjithë Kosovës ne për çdo vit ballafaqohemi me këtë problematik. Pyetje ime është a ka filluar sperkatja si dezinfektimi, deratizimi dhe dezinsketimi i këtyre, ose a pritet të filloj sepse kjo është shumë me rëndësi koha vetëm është duke kaluar, ose a ka mare ndonjë kompetencë Ministria e Shëndetësisë ose Ministria e Bujqësisë.

Florida Bajraktari – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, kam një pyetje për Drejtorin e Shërbimeve Publike, desha të di a ka filluar që të asfaltohet rruga nga Rahoveci për në Drenoc dhe fshatrat e tjerë të asaj ane, kam kaluar para disa dite nga ajo rrugë dhe me të vërtet ishte vështirë e kalueshme.

Fehmi Cena – Më vije keq të them por unë nuk kam marrë asnjë përgjigje nga pyetjet që i kam parashtruar në mbledhjen e kaluar, ku i kam pasur dy pyetje në fushën e shëndetësisë. Po ashtu edhe nga Drejtori i Financave nuk e kam marrë asnjë përgjigjen për çështjen e pjesës së buxhetit nga pjesa e SISHIT sepse mua më intereson a e ka marrë Komuna jonë atë pjesë, dhe a është e inkorporuar në pjesën e shëndetësisë apo diku tjetër. Desha po ashtu të ndërlidhem me diskutimin e Kuvendarit z. Rexhep Oruçit sa i përket çështjes së ujit të pijes, po e potencojë nga aspekti i shëndetësisë këto ditë kemi me të vërtet ndërprerje shumë të shpeshta të ujit të pijes edhe gjatë ditës por edhe gjatë natës, kjo e ngritë rrezikun e shpërthimit të sëmundjeve epidemike sepse gypat të cilat nuk kanë ujë shumë lehtë kontaminohen nga mikrobet dhe shumë lehtë mundet të vije deri tek shpërthimi i ndonjë epidemie. Pastaj klorin të cilin e vendosin aty shumë nëpër ujë gjithashtu edhe ai është i dëmshëm për shëndetin e njeriut, prandaj kërkojmë nga organet përgjegjëse të i marrin detyrat e veta me kompetencë që i kanë dhe të i kryejnë ashtu siç duhet. Mendoj se shumë herët është që të fillojë nga tani reduktimi i ujit të pijes.

Kryesuesi – I nderuari z. Fehmi Cena Drejtori i Shëndetësisë na ka njoftuar që ju ka dërguar në email përgjigjet.

Ali Zhuniqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, desha të ndërlidhem me diskutimin e z. Masar Popaj dhe znj. Shqipe Kryeziu sa i përket problemit të çështjes së shkollës mendoj se kjo duhet që të mirëtohet seriozisht si çështje, mendoj se Kryetari i Komunës e ka parë atë shkollë dhe duhet që të jetë pak më konkret sa i përket kësaj çështje, sepse me të vërtet gjendja e asaj shkolle është shumë e rëndës dhe janë fëmijët tanë të cilët vijnë në mësimet aty. Pastaj jam duke parë që vazhdimisht janë duke u adresuar pyetjet nga koleget tanë karshi drejtorëve por nuk ka ndonjë përgjigje nga ana e drejtorëve dhe në një formë nuk e krijon efektivitetin e të qenurit interaktivë karshi përgjigjeve, mendoj se ekzekutivi duhet të jetë më seriozë dhe gjithë këto pyetje që bëhen nga ana e Kuvendarëve së paku drejtori duhet të mundohet që të jetë më konkret në përgjigjet e tyre.

Fahrije Lushi Morina – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, sa i përket kësaj pika do të ndërlidhesha edhe me një çështje që ka të bëjë me aksin rrugor Radostë – Ratkoc, jeni në dijeni se shkolla e mesme është në Ratkoc dhe kjo shkollë shërben për të gjithë ato fshatra ose lokacion që gjendet afër fshatit Ratkoc, por unë kam një shqetësim për ata nxënës të cilët duhet që çdo ditë ta atakojnë atë rrugë. Këta nxënës hasin në vështirësi që janë të një rëndësie të veçantë dhe do të duhet që të merreshin me ta. I nderuari Kryetar në këtë pjesë mungojnë trotualet prandaj kisha kërkuar që të keni konsideratë dhe të merrni parasysh atë aks rrugorë, ju e dini se deri në fshatin Gexhë ka trotuare kurse nga fshati Radostë deri në Ratkoc nuk ka, për mua është e rëndësishme së veçantë sepse në fshatin Ratkoc bëhet edhe tregu në ditën e diel dhe ai aks rrugor atakohet edhe nga njerëz të ndryshëm të cilët e kanë çdo ditë jetën në rrezik sepse i mungon diçka që është elementare për kohën e sotshme.

Besmir Bytyqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, të nderuar gjithashtu edhe unë për pyetjen që e kam parashtruar në mbledhjen e kaluar nuk kam marrë përgjigje as në mënyrë elektronike po as në atë fizike, uroj që gjatë këtij mandati ta marrë përgjigjen e drejtorit. Pyetja ime për sot i drejtohet Drejtorit të Inspektoratit z. Besnik

Hoti. Një çështje shumë brengosëse për qytetarët e Komunës së Rahovecit është uzurpimi i trotuareve nga ana e bizneseve, në shumë pjesë të qytetit bizneset e ndryshme i vendosin gjërat e tyre jashtë nëpër trotuare ku me këtë i pengojnë qarkullimin e lirë qytetarëve, kjo mundet të sjellë shumë pasoja si ato fizike po ashtu mundet të jetë edhe cenim i jetës së personave e sidomos për fëmijët. Pyetje ime është: Çka do të bëjë konkretisht qeveria Komunale lidhur me këtë problem. Pyetje e dytë shkon për Drejtorin e Shëndetësisë z. Samir Mustafa, kjo pyetje ka të bëjë me projektin e Caritasit, dua ta di a është e nënshkruar marrëveshja, në çfarë stadi jemi dhe çka po ndodhë me këtë marrëveshje, ka disa muaj që thuhet këtë javë, javën tjetër, të interesuarit duan ta din se kur do të përfundojë kjo.

Dervish Çadraku — Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, kam disa pyetje por pyetje ime e parë ka të bëjë me ujin e pijes që është folur bukur moti nga Dobidolli që shkon ka Polluzha dhe ato fshatrat andej, është folur shumë që është hequr edhe një pjesë e gypave por megjithatë ato fshatra ende nuk kanë ujë, banorët e asaj ane kërkojnë një përgjigje se çka është duke ndodhur, të ju them sinqerisht kam dëgjuar që do të ketë edhe protestë në këtë drejtim prandaj i nderuari Kryetar është mirë që të merreni me këtë punë sepse siç e tha edhe njëri nga kolegët tanë që uji tani në kohë vere është edhe më i domosdoshëm. Pyetja e dytë është: Duke shfrytëzuar rastin e ditës së librit ne e kemi bërë një vizitë në bibliotekën e qytetit, kjo bibliotekë e cila është hapur në vitin 1960 e cila kishte 7 njësi, ajo sot i kishte diku 13 mijë ekzemplarë kurse njësitë e tjera nuk ishin duke funksionuar asnjë. Në këtë bibliotekë kishte mjaftë dobësi për të cilat kishte me qen mirë që të interesoheni dhe të i plotësoni ato kriteret, në radhë të parë nuk kishte hapësirë të mjaftueshme edhe për bibliotekë edhe për muze, kishte me qenë mirë që të kërkohej një hapësirë e re për bibliotekë, po ashtu kishte mungesë të ndriçimit, por ajo që ishte më interesante edhe literatura e njeriut që e mbanë emrin kjo bibliotekë “Sylejman Krasniqi” nuk e kishte krijimtarinë aty, ndoshta ti i nderuari Kryetar e ke lexuar dorë pas dore por kishte me qenë mirë që të jetë prezentë që ta lexojnë edhe të tjerët. Po ashtu kjo bibliotekë kishte probleme edhe me teknologjinë informative sepse kishte me qen mirë që të funksionoj edhe online ajo bibliotekë, pastaj kishte mungesë të vulës, kartelave shumë e shumë gjëra të tjera për të cilat ju kisha lutë që ti evidentoni dhe të i plotësoni ato dhe këtë bibliotekë një herë e mirë ta furnizoni sepse me të vërtetë është për të ardhur keqe që në vitet 1960 të hapet kjo bibliotekë e cila i ka pasur 7 njësi kurse sot të i ketë vetëm 2 njësi dhe me disa tituj shumë të varfët. Pyetje e tretë është, i nderuari me të vërtetë unë nuk kam dëgjuar as nga njerëzit por as nga mediat që ka ndodhur ndonjëherë kontrollimi sistematik i nxënësve të shkollave tona, a keni ndërmend të bëni kontrollimin sistematik nxënësve nëpër shkolla sepse me të vërtetë është shumë e nevojshme dhe e domosdoshme dhe është mirë që kjo të bëhet kulturë sepse ka sëmundje të ndryshme të cilat është mirë që në fillim të i evidentojmë.

Vjosa Isma — Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, Pyetje ime shkon për Drejtorin e Kulturës z. Ervin Hoxhën i cili sot ma ka kthyer një përgjigje përmes emailit, por dua që të ja rikujtoj drejtorit që nuk ka punuar përmes rregullores së Ministrisë së Financave me Nr. 04/2017 e cila i shfuqizon të gjitha rregulloret e tjera të cilat kanë të bëjnë me subvencionimin e OJQ-ve. Pyetje e dytë shkon për Drejtorin e Arsimit z. Avni Morina i cili nuk ka dashur të përgjigjet përmes emailit por ka kërkuar që pyetjet të bëhen gjatë mbledhjes, drejtori i nderuari fletë që ka bërë sistemimin e punëtorëve por në këtë rast ai ka bërë transferim të punëtorëve, sipas nenit 17 të ligjit të punës flitet për sistemim, riorganizim në momentin kur zvogëlohet norma e nxënësve, mirëpo në këtë rast nuk është zvogëluar norma e nxënësve por vetëm është bërë transferim i mësimdhënësve nga një shkollë në shkollën tjetër. Po ashtu nuk kam marrë përgjigje sa i përket bursave për studentë, kam bërë pyetje dy herë përmes emailit por asnjë përgjigje nuk kam marrë, në mbledhjen e kaluar kam marrë një përgjigje nga Kryetari i cili ka thënë se është bërë ndarja përmes kriterëve, por sipas kriterëve që kanë qen në konkurs një kriter nuk është respektuar, e kam cekë atë kriter përmes emailit por përgjigje nuk kam marrë. Në kriter ceket se përfituesit që janë të një burse nga pushteti qendrorë ose ndonjë donator tjetër për fushën e njëjtë nuk do të marrin bursë nga Kuvendi Komunal, e kjo nuk është respektuar sepse ka ndodhur me studentët që kanë përfutur bursë nga Komuna.

Kryesuesi — Pyetjet e nderuarës Kuvendare znj. Vjosa Isma i parashtroni në Kuvend e jo të i parashtroni nga shtëpia me anë të emailit.

Rasim Fazliu - Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, shqetësime të qytetarëve ka mjaftë jo vetëm në këtë mandat por edhe në mandatet e kaluar ka pasur por edhe në mandatet që do të vijë do të ketë, ne gjithmonë do të kemi punë dhe angazhime, por mirë është që janë duke u ngritur këtë shqetësime. Kolegu imë e ngriti një çështje për kullimin e tokave, e kam pasur një konsultim me Kryetarin dhe Kryesuesin e Kuvendit ku kemi diskutuar për çështjen e kullimit të tokave në trekëndëshin Xërxë – Celinë – Fortesë, por desha të bëjë pyetjen konkrete a ka diçka për këtë vit meqenëse në kornizën afatmesme buxhetore janë paraparë mjetet për projektet për kullimin e tokave. Nuk kam më pyetje por desha të bëjë një propozim ose sugjerim nëse janë të pajtimit edhe kolegët e mijë me atë që do të them tani. Për arsye që pyetjet dhe përgjigjet që jepen nga drejtorët dhe Kryetari i Komunës të mos përsëriten nga ne, do të ishte mirë që ne të marrim një qëndrim këtu që të gjitha përgjigjet që jepen nga ekzekutivi të jepen në foltore që ti dëgjojmë të gjithë, në mënyrë nëse kolegu imë e ka ngritë një çështje të mos e përsërisim ne prapë.

Ali Morina – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, desha të i ngrisë 2 çështje, e parë është për përmirësimin e rrjetit të kanalizimit e dimë që është kompetencë rajonale e KRU-Gjakova e cila e bënë edhe faturimin e mirëmbajtjes së këtij rrjeti, mirëpo në pjesën fushore ku shtrihet rrjeti ata thonë se nuk është kompetencë e tyre, problemi më i madh është se kanalizimi bllokohet po në ato pjesë, prandaj pyetje ime për Drejtorin e Shërbimeve Publike është: Kur do të filloj hapja dhe mirëmbajtja e këtij rrjeti, nëse shkohet me periudhë ende më të gjatë bujqit do të fillojnë të i punojnë tokat e tyre dhe pastaj do të jetë më problem për intervenim. Pyetja tjetër lidhet po ashtu me rrugë fushore si në Ratkoc ashtu edhe për të gjitha vendbanimet e Komunës së Rahovecit, pyetja ime prapë është për Drejtorin e Shërbimeve Publike, kur do të filloj rregullimi i këtyre rrugëve fushore, me qëllim që bujqve të ju mundësohet një qasje më e lehtë për tek arat e tyre.

Kryetari – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë, mirë shumë që pati pyetje nga ana e juaj dhe ne si ekzekutiv jemi të interesuar që ti dëgjojmë pyetjet me vëmendje, të i marrim shqetësimet, nevojat dhe kërkesat me vëmendje, po ashtu me seriozitetin më të madh të ju japim përgjigje. Kam përshtypje se disa janë duke i marrë përgjigje prandaj le ti adresohen Qeverisë Komunale në mënyrë që mos të ngarkojnë Kuvendin. I nderuari Vahid Krasniqi ka ngritë disa çështje ku i ka mare përgjigjet nga Kryetari i Komunës në mbledhjen e kaluar, për subvencionet nga DKRS-ja për klubet sportive dhe sigurisht është mirë që ta pyetni Kryetarin e klubit se sa është ritë vlere e shpenzimeve pas marrjes së subvencioneve me ato udhëtimet që janë duke i bërë klubi futbollit dhe pyeti a e kanë mbërri vlerën prej 1,000.00 € , pra përveç 2,100.00 € që ju kanë ndarë nga subvencionet. Çështje tjetër që e ka ngritë ky rreth kësaj parcele e cila është në menaxhimin e agjensionit pyjorë të Kosovës, ne këtë do të shqyrtojmë me shumë kujdes sepse ne kemi situata të cilat nuk mundën të tejkalohen lehtë pa pasur ndonjë arsyetim tepër të bazuar me projekt shumë konkretë dhe me një rëndësi shumë të veçantë. Pyetjen të cilën e ka ngritur Kuvendari z. Rexhep Oruqi rreth furnizimit me ujë për lagjen e epërme të qytetit, ne i nderuar e kemi biseduar këtë çështje me Drejtorin e KRU- Radoniqit, ata kanë pasur disa ndërhyrje disa veprime dhe ne nga ta kemi kërkuar shumë seriozisht që çështje e furnizimit me ujë të pijes në pjesët kodrinore të qytetit ku pajtohem se ka pasur ndërprerje edhe në muajin prill, por besoj se do të stabilizohet sepse ata e kanë mare seriozisht mesazhin tonë, po ashtu apelojë edhe nga kjo Mbledhje e Kuvendit që drejtori i KRU- Radoniqit që me të vërtetë të kujdeset për furnizimin sa më të mirë me ujë të pijes për pjesën kodrinore të qytetit. Nuk e kam kuptuar shqetësimin që e ka ngritë z. Rexhep Oruqi për ditën e dhurimit të gjakut në fshatin Dejnë, a e ka pasur fjalën për Festivalin Folklorik “Anadrina Jehon”, po nëse është për dhurim të gjakut ne deri më tani nuk kemi asnjë kërkesë zyrtare nga organizatorët për ti ndihmuar, por ne sidoqoftë jemi për ti ndihmuar. U ngritën disa shqetësime rreth shkollës fillore “Iliria” në Fortesë që janë legjitime dhe është shumë e vërtetë që është në një gjendje shumë të keqe kjo shkollë. Do ju përgjigjem të gjithë atyre që e kanë ngritur këtë çështje, është hequr nga eficientia e energjisë shkolla “Liria” e Fortesës ngase nuk ka kuptim të investohet në një shkollë që meriton të jetë e re, është e vërtetë se nga shllolla fillore “Liria” Fortesë projekti i eficientës ka shkuar në shkollën “Vëllezërit Frashëri” në Drenoc dhe se mirë kemi vepruar sepse atje mundemi të i përgjigjem kërkesave nevojave dhe gjendjen mundemi ta sanojmë me eficientë të energjisë. Kurse në shkollën fillore “Liria” në Fortesë ka 2-3 arsye kryesore pse ka ndodhur kjo, e parë sepse është në pikën më të ulët dhe ne nuk kemi kapacitete me e ngritë kompletë shkollën

sepse nuk jemi japonez, pastaj ajo shkollë duhet që të rrënohet dhe të bëhet ndërtimi i një shkolle të re dhe ne e kemi gati projektin e shkollës së re së bashku me sallën e edukatës fizike për në Fortesë, nuk është projekt i fituar por është projekt i hartuar dhe ne do të llojmë që ta ndërtoj më këtë shkollë. Nuk kemi zgjidhje të shpejtë për momentin për shkollën fillore “Liria” në Fortesë ne e dimë se në çfarë gjendje është pra të gjitha problemet të cilat nuk duhet që ti ketë një objekt i ka ajo shkollë, ne jemi duke synuar që ta fusim në planifikim si Komunë kurse nëse mundemi të gjejmë donatorë që të na ndihmojnë do të jetë edhe më mirë. Njëjtë do të jetë besoj edhe me shkollën fillore në fshatin Xërxë, kurse me shkollën fillore “Milaim Krasniqi” në Pastasel është projekti me efikasitet të energjisë që do të trajtohet në këtë vit. E nderuara znj. Hanalora Hoti ka parashtruar një pyetje sa i përket kubëzimit të rrugëve, nuk është se kemi trashëguar ndonjë planifikim për kubëzimin e rrugëve por sidoqoftë ne i kemi parasysh ato shqetësime sepse ka plotë rrugë të cilat duhet që të rregullohen qoftë me asfaltë e qoftë me kubëza, por shpresojmë për një zgjidhje më të mirë edhe me rishikim të buxhetit, sigurisht se ka disa projekte të cilat janë të planifikuara si kubëzim i rrugëve në disa fshatra, lagje të qytetit etj. sa i përket mbeturinave me 02.05.2018 ju ftoj të gjithë juve anëtarëve të Kuvendit të Komunës, të gjitha subjektet politike, kryetarët e lagjeve, fshatrave dhe këshillat e fshatrave, operatorët i kemi ftuar dhe ndërmarrjet të cilët mirën me pastrim të ambientit, në këtë datë fillon një aksion i përgjithshëm para se gjithash është obligim i yni dhe sigurisht kjo e ka edhe peshën e vetë sepse nëse ne do të mbërrijmë që të kemi një ambiente të gjelbëruar dhe të pastër atëherë mundemi të përfitojmë diçka speciale edhe nga Ministria e Planifikimit Hapësinorë dhe Mbrojtje të Mjedisit. Siç e dini të gjithë dita e tokës është zgjedhur që të festohet në Rahovec, ne kemi krijuar një marrëdhënie të shkëlqyer me këtë ministri prandaj ne duhet që të dëshmojmë se mundemi që të heqim të gjitha mbeturinat dhe dëbonit ilegale qofshin të ngurta ose të amvisërisë, ne e kemi bërë planin operativ për pastrim që fillon nga 2 maji kurse do të përfundoj kur të hiqen të gjitha mbeturinat. E njëjta përgjigje vlen edhe për të nderuarën znj. Mirjeta Krasniqin sa i përket kubëzimit të rrugëve, por ne do të përpiqemi që ta kapitalizojmë sa më shpejtë përmbylljen e projekteve të investimeve në infrastrukturë rrugore, ne jemi të interesuar që mos të kemi më nevojë për të ndërtuar rrugë të reja pra të përfundojmë këtë kapitull, por të i mirëmbajmë rrugët ekzistuese. Z. Refki Kryeziu ka folur për kullimin e tokave bujqësore ku u ndërlidh edhe me z. Rasim Fazliun, ne kemi të planifikuar një kod dhe besoj se këtë vit do të ketë veprime të caktuara të cilat do të kenë për qëllim që të zgjidhin këtë problem si në Xërxë, Celin dhe Fortes. Ne do të sigurohemi që ky projekt të jetë i qëndrueshëm dhe nuk do të kemi më përmbytje të tokave bujqësore, ishte edhe pyetja se kur do të përfundoj, ne jemi të interesuar me një plan dinamik dhe me një intensitet të shtuar të punimeve por duhet që të dini se nuk varet gjithçka nga ne, por varet edhe nga mundësitë buxhetore të cilat besoj se do ti kemi të mjaftueshme që të përmbyllet sa më shpejtë ky projekt. Sa i përket ndriçimit publik po ju njoftoj juve se fondi i performancës prej 95,000.00 € një pjesë e madhe e këtij fondi do të shkojë për ndriçim publik në fshatin Xërxë. Por i nderuari z. Refki ka edhe plotë fshatrat e tjerë që nuk kanë fare ndriçim publik dhe janë qendra sekondare të Komunës sonë, ne nuk jemi mirë askund nëpër fshatra me ndriçim publik përveç qytetit që jam tepër i kënaqur me ecurinë e punimeve në sferën e ndriçimit publik, kanë mbetur edhe 5 rrugë kryesore që do të përmbyllet shumë shpejtë, por po ju them se fshati Xërxë ka prioritet qysh tani. Të nderuarës znj. Shqipe Kryeziu ju përgjigja sa i përket efikasitetit. Z. Afrim Berisha pyeti rreth përfshirjes në Statutin e Komunës Festivalin Folklorik Kombëtar “Anadrinia Jehon”, lusë kuvendin e Komunës që në mbledhjen e radhës të formojë një komision për plotësim ndryshim të Statutit të Komunës ku do ja filloja nga logoja e Komunës dhe të gjithë ato që nuk janë përfshirë në Statut. Sa i përket varrezave të besimit katolik jam në dijeni për këtë problem, jemi në dijeni se kur vdes ndokush nga vëllezërit tanë të besimit katolik janë të detyruar në kushtet e dimrit të i varrosin në fshatin Doblibar, kjo është gabim dhe shumë shpejtë do të futet në planifikim dhe ai problem duhet që të zgjidhet sa më shpejtë. Sa i përket rriqrave që pyeti e nderuara znj. Florije Boshnjaku ne kemi një projekt diku 20,000.00 € nuk jam shumë i sigurt se a duhet që të shpenzohen të gjitha këto mjete por jam shumë i sigurt se dezinfektimi, deratizimi dhe dezinfektimi do të ndodhë në Komunën tonë dhe ne natyrisht se do të koordinohemi me Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik me strategjinë nacionale të institutit Kombëtar të shëndetit publik dhe besoj se do të kmei një situatë normale sa i takon luftimit ose preventivave kundra rriqrave. E nderuara znj. Florida Bajraktari ka pyetur

për riparimin e rrugës Sarosh, e nderuar ka filluar asfaltimi i kësaj rruge, më ka ardhur shumë keq që nuk ka qenë asfaltuar atë ditë që e kemi festuar 20 vjetorin e daljes së UÇK-së, por siç e dini është projekt të cilin e administron Ministria e Infrastrukturës por besoj se ky problem brenda pak ditëve do të zgjidhet. Kam kërkuar që të zgjerohen ato kthesat e mëdha që janë rrugës për Polluzhë sepse ato përbëjnë rreziqe. Z. Fehmi Cena për ndërprerje të ujit ju përgjigja, kurse pyetjen që ju keni parashtruar drejtorit z. Samir Mustafa besoj se ju ka kthyer me emal, nëse jo i ftoj të gjithë Drejtorët e mijë që ta lexojnë procesverbalin sepse vullneti politik i kësaj qeverie është që të jepe përgjigje sa më të mirë të mundshme dhe sa më të qartë, po ju them ja këtu publikisht se drejtorët e mijë duhet që të ju japin përgjigje për çfarëdo teme ju kërkoni, qoftë në foltore qoftë me shkrim. Z. Ali Zhuniqi po ashtu ka kërkuar nga Drejtorët që të jenë më efikentë dhe ma efikase në dhënien e përgjigjeve, sa i përket shkollës në Fortesë ju dhashtë përgjigje: E nderuara znj. Fahrje Lushi ka përmendë aksi rrugor Ratkoc - Malësi e Vogël, në zotimet e mija e kam thënë se trotuare do të ketë në dy anë të rrugëve dhe kjo do të bëhet natyrisht aty ku kemi hapësirë, po ashtu duhet që të marrim një pëlqim nga Ministria e Infrastrukturës sepse ashtu është e paraparë me ligj, po ne nuk mundemi tani për tani sepse nuk kemi mundësi, por po ju them se në planifikimet e vitit 2019 plotë pozicione të cilat janë shqetësime të qytetarëve do të hynë në planifikim. E nderuara znj. Besmira Bytyqi, sa i përket SHL-Kosova ke marrë përgjigje direkt nga unë nëse ka nevojë për përgjigje shtesë po e plotësoj, me SHL-Kosova kemi një marrëdhënie tepër serioze dhe ne zhvillojmë shumë aktivitete për të cilat e ftoj edhe znj. Besa që ti bashkëngjitet e di që më herët ka qenë më aktive me SHL-Kosova pse të mos jetë edhe tani. Ne do i mbështesim në vazhdimësi edhe ma bashkëpunim edhe me marrëdhënie të tjera njëkohësisht edhe me financa sepse ata i kanë disa shpenzime që besoj se do të kemi mundësi ne të i mbështesim gjatë këtij viti. Sa i përket marrëveshjes me Caritasin, kjo marrëveshje me 2 maj fillon së zbatuari avancimi i shërbimeve, kohë zgjatja e shërbimeve në qytet dhe në fshat në qendrat e mjekësisë familjare dhe në shtëpitë më të vogla të shëndetit. Sigurisht për seancat e ardhshme do ti japim informacion të plotë përkitazi me trajtimin e kësaj problematike. Marrëveshjen me Caritas Kosovën Kryetari i Komunës e ka nënshkruar, në vitin e kaluar në qershor është nënshkruar, kurse tani është nënshkruar në muajin maj pra një muaj përpara. Z. Dervish Çadraku pyeti për libra, i nderuar tenderi për libra, ne e dimë se biblioteka është në një gjendje jo të mirë, nuk është e pasur shumë dhe ne këtë vit mendojmë me e pasuru bibliotekën e qytetit dhe ato mungesa të cilat i trajtoj këshilltari i nderuar z. Dervish Çadraku besoj se ne duhet me i dhënë kuptim dhe të i japim më shumë vlerë, më shumë mundësi dhe më shumë kushte bibliotekës “Sylejman Krasniqi” në qytet. Ne planifikojmë të organizojmë diçka për nder të dëshmorit “Sylejman Krasniqi” këtë vit dhe besojmë se do të kemi një mori titujsh të ri dhe një sasi të konsiderueshme të librave, për sa i takon atyre njësisë sa funksionojnë e sa jo, e di që ka mangësi plotë po ashtu e dimë që kjo bibliotekë ka pasur disa riparime në mandatin e kaluar, për mua janë të çuditshme disa mungesa pse janë sot ne do të përpiqemi që ti kompensojmë këto mungesa sa i takon investimeve në objektin e bibliotekës. Pastaj kontrolli sistematik i nxënësve nëpër shkolla do të ketë sidomos tani që është bërë rritja e efikasitetit të shërbimeve primare shëndetësore. Ne do ta kemi një plan dhe sigurisht të gjitha shkollat në muajin maj ose qershor ajo varet prej drejtorëve kur do ta caktojnë vizitat sistematike shëndetësore nëpër gjitha shkollat e Komunës së Rahovecit. Sa i përket ujit të pijes për fshatrat Pastasel dhe Guri i Kuq, ne shpresojmë që do të rregullohet shumë shpejtë dhe do të ketë ujë për fshatrat Guri i Kuq, Polluzhë, kurse sa i takon fshatit Pastasel ai mundet të vonohet dhe të rregullohet pak më vonë, por këtë vit shpresojmë se edhe për këtë fshat do të kemi situata pozitive. Arsyeja për protestë nga qytetarët ekziston sepse është një projekt që ka zgjatur me vite por ne shpresojmë se tani i kemi parakushtet që të kemi ujë të pijes para se të vijnë mërgimtarët. E nderuara znj. Vjosa Isma pyeti sa i përket subvencionimit të OJQ-ve nga DKRS-ja, e nderuar ne kompetent jemi të gjithë por të thirrur për të dhënë interpretimet ligjore Komuna e ka zyrën ligjore e cila është në koordinim të plotë me MAPL-në dhe ata neve na kanë dhënë pëlqimin që jemi në rregull dhe të veprojmë në këtë drejtim. Kanë aplikuar OJQ-të dhe i kanë fituar ato të drejta që të mbështeten nga Komuna e Rahovecit. Sa i takon bursave po ju siguroj këtu publikisht, studenti i cili e ka notën mesatare 9 le të merë bursë edhe në Amerikë unë deri sa të jem Kryetar Komune kam me ja dhënë bursën sepse është meritë, unë këtë kriter kur nuk e qes por ky

konkurse nuk është shpallur nga ne por është shpallur nga qeverisja e kaluar. Ne kemi politikën tonë të stimulimit dhe përkrahjes së studentëve të cilët tregojnë performancë, nëse nuk është respektuar ky kriter në këtë konkurse unë i kërkoj falje Kuvendit por unë kam insistuar që ata studentë që kanë notën mesatare 9 le ti marrin edhe 30 bursa tjera shtesë por ata duhet që të marrin bursë edhe nga Komuna e Rahovecit. Nëse ne je japim një bursë një studenti i cili i ka plotësuar të gjitha kriteret e konkursit por notën mesatare e ka 6 dhe nuk ja japim një studenti i cili e ka notën mesatare 9 kjo nuk e besoj se është diçka e mirë. Sa i përket transferimeve besoj se Drejtori i DKA-së ju ka dhënë përgjigje, ju falënderoj të gjithëve për kontributin që e keni dhënë në këtë pikë.

Ali Zhuniqi – Desha të ndalem edhe pak tek investimi i shkollës “Liria” në Fortesë, ju nuk e dhatë ndonjë plan konkret sa i përket afatit kohorë karshi investimeve përveç se e ceke se ne nëse do të gjejmë donatorë për ndërtimin e shkollës do të marrim hapa konkret, gjë që le hapësirë që nëse brenda një mandati ju nuk mundemi me e gjete ndonjë donator do të thotë se në atë shkollë nuk do të ketë investime fare.

Kryetari – I nderuar po të lusë që kur të flas të më dëgjosh me vëmendje po ju përsëris edhe njëherë, e thash pak më parë se në planifikimin e vitit 2019 do të futet kodi nga Komuna për ndërtimin e shkollës fillore “Liria” në Fortesë, po shpresojmë ne të gjejmë donatorë, ajo shkollë do të ndërtohet shumë shpejtë por këtë vit nuk kemi mundësi i nderuar sepse nuk është e planifikuar.

Vahid Krasniqi – Mos ti interpretojme keq pyetjet dhe përgjigjet, pyetjen e parë që ta kam bërë kam thënë se është neglizhuar klubi i Dejnrit dhe i Drenocit në krahasim me klubet e tjera të të njëjtës ligë siç është Xërxa dhe Ratkoci dhe për këtë përgjigje nuk kam marrë. Pyetje e dytë kam thënë pse kërkesa nuk është protokolluar në afatin ligjor kur është dorëzuar edhe për këtë nuk kam marrë përgjigje. Kurse në pyetjen e tretë që e thua ti që ta pyes trajnerin e klubit se sa ka arritur vlera e shpenzimeve të udhëtimit për lojë që zhvillohen jashtë vendit, kjo nuk krahasohet me përgjigjen që na keni dhënë sepse këto shpenzime krijojnë edhe klubet e tjera, atëherë ku është duke shkuar vlera e shpenzimeve të klubit të Xërxës dhe Ratkocit dhe ku po shkon vlera e klubit të Drenocit që janë të rangut të njëjtë, asnjë ligj ose udhëzim administrativ nuk bënë kësi dallime për ndarjen e subvencioneve.

Kryetari - I nderuari z. Vahid edhe një herë do të përgjigjem decidivishtë, të jam përgjigjur edhe atëherë por po ta përsërisë të njëjtën përgjigje e cila besoj se është e saktë. 2,200.00 € i ka marrë klubi i Dejnrit, 2,200.00 € i ka marrë klubi i Drenocit, jam shumë i kënaqur që kam pas mundësi të i ndihmojë këtyre dy klubeve, do të isha shumë i kënaqur që të kem mundësi me i dalë në ndihmë çdo klubi sportiv çfarëdo disipline sportive të jetë. I kam nënshkruar dy kontrata me të njëjtin njeri edhe për shkollën e futbollit edhe për klubin e futbollit dhe jam shumë i kënaqur me mundësit e Komunës së Rahovecit që po kemi mundësi me i dalë në mbështetje klubeve, kjo nuk është në kundërshtim as me udhëzimin administrativ, as me ndonjë rregullore sepse prioritetet për këtë çështje në bazë të nevojave dhe kërkesave i cakton Kryetari i Komunës dhe qeveria Komunale e nuk i cakton në këtë rast një ose dy Kuvendar. Kryetari i Komunës së bashku me DKRS-në e dinë më së mirë se si duhet të adresohen këto çështje. Sa i përket pyetjes së dytë mundesh të i drejtohesh ndonjë organi tjetër se a kemi pasur të drejtë apo jo, por kur ta sjellim raportin në fund të vitet atëherë ne mundemi të diskutojmë. Sa i përket përgjigjeve që i ke marrë ti mundesh mos me qenë i kënaqur, por ne ato përgjigje ti kemi dhënë në mbledhjen e kaluar për këtë çështje dhe prapë jam i gatshëm të njëjtën përgjigje me ta dhënë sa herë që ti dëshiron.

Rasim Fazliu - I nderuari Kryesues kishte me qenë mirë që të futni në votim propozimin tim sepse siç e thash nuk do të përsëriten pyetjet nga Kuvendarët.

Nënkryetari – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, lidhur me këtë propozim që është duke e dhënë z. Fazliu, mundet të bëhet kjo por në anën tjetër i mohohet e drejta e drejtorit që të jepe përgjigje me shkrim sepse ai e ka këtë të garantuar me ligj që mundet të kthejë përgjigje me shkrim ose me gojë. Ne 4 vite kemi bërë pyetje dhe nuk kemi marrë përgjigje asnjëherë ju këtë e dini shumë mirë.

Rasim Fazliu – I nderuari Nënkryetar nuk kemi nevojë të bëjmë krahasime dhe të them të drejtën nuk më pëlqen që të bëjë krahasime, nëse unë kam gabuar dje ti atëherë mos gabo, propozimin nuk e bërë as politikisht po ashtu Kryesuesi i Kuvendit është i obliguar që ta qes në votim propozimin, ndërsa Kuvendarët janë ata që vendosin.

Kryetari – Pajtohem me propozimin por është një çështje e cila mundet të merë përgjigje me shkrim, mundet që të krijohet një bazë që të vonohen këto çështje sepse Drejtori me anë të shkrimit ka mundësi menjëherë të nesërmit të i përgjigjet Kuvendarit, nëse ne vendosim që çdo përgjigje me e dhënë në foltore atëherë mundet të ekzistojë mundësia që mos të jemi të kënaqur shumë me kohën, por ata që janë të pakënaqur me përgjigje me shkrim mundet të kërkojnë përgjigje shtesë të i jepe drejtori në foltore. Po ashtu ju të gjitha përgjigjet dhe pyetjet që i keni bërë do ti keni në procesverbal, prandaj mendoj se nuk ka nevojë të futet në votim ky propozim kur ka mundësi që të zgjidhet në mënyrë shumë të drejtë përmes përgjigjeve me shkrim ose me gojë varësisht se si e kërkon Kuvendari.

Munib Durguti – Përsëendetje për të gjithë të pranishmit, po ashtu edhe unë e kisha të njëjtën brengë sikurse z. Rasim Fazliu sepse në një farë forme pyetje është duke u bërë publikisht kurse përgjigja i kthehet në mënyrë personale, pastaj shumë nga ne Kuvendarë mbesim të pa informuar. Por propozimi i Kryetarit që përgjigjet të inkorporohen në kuadër të procesverbalit mendoj se do të ishte diçka shumë e mirë dhe secili nga ne do të kemi qasje në ato përgjigje.

Kryetari - Të nderuar ne nuk mundemi të gjitha pyetjet që i bëni ju sot të i mbajmë në mend, por ne e shikojmë transkriptin dhe mbi bazën e atij transkripti ne ju japim përgjigje.

Sali Sallteku – Përsëendetje për të gjithë të pranishmit, ne e përkrahim propozimin e shefit të grupit tonë, nuk e di pse është duke ju penguar që të futni në votim, ne mundemi që të bisedojmë sa doni por përgjigjet me shkrim nuk shkojnë direkt tek të gjithë. Nën kryetari paska vërejtje që më parë nuk ju janë kthyer përgjigjet por nëse kish kërkuar në kohën tonë këtë propozim ne kemi pas mundësi me e qit. Prandaj z. Rasim është duke kërkuar një të drejtë dhe nëse ma kthen përgjigjen mirë me shkrim atëherë askush nuk e përsërit pyetjen por nëse jo atëherë dalim dhe e shohim njëri tjetrin sy me sy ma mirë.

Flori Boshnjaku – Desha të ndërlidhem me këtë pyetje plotësisht pajtohem me z. Rasimin që ne nuk dëshirojmë që të kthehemi mbrapa, pikërisht unë kam kërkuar që të dilet në foltore dhe të jepen përgjigje por ne kolegët në atë kohë jemi dakorduar që mos të bëhet kjo sepse mbledhja na zgjatke 4-5 orë dhe kur është dashur të diskutojmë rreth pikave të rendit të ditës nuk kemi mundur sepse jemi lodhur. Pra nëse ne tani prapë kthehemi dhe diskutojmë pse ti pse unë 7-8 orë nuk e di se si do të diskutojmë për rendin e ditës kur do të jetë me 10-12 pika, se nuk ka kurrfarë problemi se plotësisht isha pajtuar sepse ne jemi koleg sikurse z. Rasim sikurse unë kemi me qen në mbledhje. Ne jemi 31 Kuvendarë nga 2 pyetje dhe 2 përgjigje atëherë duhet të qëndrojmë së paku 10 orë siç kemi qëndruar më parë, më vije keq por më parë pa e filluar me rendin e ditës e kemi leshur mbledhjen dhe ka pasur raste kur i kanë pyetur kolegët a e keni kryer mbledhjen, përgjigja e tyre ka qen po e kemi kryer, kjo është arsyeja se shqetësimet e z. Rasim janë edhe shqetësimet tona sepse ne jemi për interes të përgjithshëm.

Sali Sallteku – Nuk është e vërtetë që e kemi lënë kurë, nuk e di se çka ju pengon, pastaj marrish goxha të holla për vetëm 2 ditë në muaj që vjen, ne jemi këtu për të debatuar. Ka kërkuar shefi i grupit tonë dhe është mirë që të futet në votim po jo atë e vendosin Kuvendarët.

Fehmi Cena – Edhe ne mendojmë se propozimi i delegatit z. Rasim Fazliu është i arsyeshëm dhe asgjë nuk ka të keqe, arsyeja është se shumica e pyetjeve ne që i adresojmë këtu ngrisin çështje të interesit të përgjithshëm, prandaj edhe ky propozim është në interesin tonë ne i ngrisim çështjet dhe shumica e çështjeve kërkojnë edhe debate pak më të gjëra në mënyrë që të i japim një zgjidhje sa më të mirë. Ne edhe ashtu takohemi një herë në muaj edhe nëse e humbin tërë ditën nuk është me rëndësi, ne jemi të interesuar që për të gjitha çështjet të kemi njohuri, prandaj ndryshe është informimi drejtpërsëdrejti në foltore e ndryshe vetëm informim personal.

Kryetari – Nëse e vlerësoni ju që ta hedhim këtë propozim në votim nuk ka kurrfarë problemi, por ju siguroj se unë dhe drejtorët e mijë do të ju japim përgjigje për çfarëdo që ju pyetni dhe ne dimë të ju përgjigjem, kuptohet se jo të gjitha ne i dimë por ne jemi të obliguar që të ju japim përgjigje me shkrim, me gojë sipas rasteve, nevojave dhe sipas kërkesave. Prandaj mos të i shkojë në mendje asnjë grupi të Kuvendarëve se Kryetari i Komunës me drejtorë ka me tentuar që të i shmangët përgjigjeve, ne jemi këtu por unë e thash për hire të menaxhimit më të mirë të kohës sepse sot ne jemi në këtë pikë duke debatuar gati që 2 orë. Ju si të doni ne mundemi që të ju sjellim edhe përgjigje zyrtare me shkrim individualisht kjo është normale kështu bëhet edhe në

Kuvendin e Republikës së Kosovës, pastaj ka edhe përgjigje me interpelancë drejtpërsëdrejti, pra ka disa lloje të përgjigjeve, ne jemi të gatshëm për të gjitha dhe të gjitha sipas rastit mundemi që të aplikojmë, por nëse e aplikojmë vetëm këtë përgjigje në foltore atëherë do të humbim shumë kohë.

Rexhep Oruçi – Përsëritje për të gjithë, E mora fjalët për ti ndihmuar kësaj çështje, kur është kryetari prezent në mbledhje ne shumë lehtë i marrim përgjigjet sikurse sot që i morëm diku 90% të përgjigjeve dhe këto pyetje më nuk ka nevojë të përsëriten, por në ato mbledhje që nuk është prezent Kryetari Drejtorët nuk janë duke na dhënë përgjigje, ndoshta dikujt ja kthejnë me shkrim por ne si Kuvendë nuk jemi të informuar pastaj janë duke u përsëritur pyetjet.

Kryetari – Nëse nuk është Kryetari prezent në mbledhje ju siguroj se përgjigjet do ti merrni nga drejtorët, ai drejtor i cili nuk ju kthen përgjigje me shkrim ju premtoj se atë ditë do të lirohet nga detyra, ai mundet të jep ndoshta përgjigje jo të mirë, jo të saktë, por përgjigje do ju jep.

Dervish Çadraku - Jam duke parë që ka interesim të madh që propozimi i z. Rasim të hedhet në votim, por po ashtu jam duke parë se gati që 2 orë jemi duke bërë pyetje dhe përgjigje, nëse ju kishit me insistuar i nderuari Kryetar kisha mëndu se ju e bëni me qëllim që të na lodhni neve në mënyrë që kur të hymë në tema më serioze ne të jemi të lodhur. Ju mundeni ta futni në votim por me të vërtet jemi duke humbur kohë sepse nëse tani mirën edhe përgjigjet atëherë besoj se edhe 5 orë nuk mundet të kryhet kjo pikë dhe me këtë humbë kuptimi i mbledhjes së Kuvendit, kishte me qen më mirë atëherë një ditë të mbahet mbledhja vetëm me pyetje dhe përgjigje edhe pse e di që janë të rëndësishme, por mendoj se nuk janë më të rëndësishme se temat e tjera të cilat duhet ne të i shpjegojmë këtu.

Rasim Fazliu – I nderuari Kryesues nëse me të vërtet je Kryesues i Kuvendit atëherë nuk duhet që ta tejkalosh këtë propozim, me të vërtet unë e propozova këtë propozim që të njihemi me të gjitha problemet, kurse ju tani me të vërtet e problematizuat këtë çështje edhe pse nuk është fare problematike. Kurse unë z. Dervish Çadraku dhe këta të tjerë jemi këtu që ti mbrojmë interesat dhe shqetësimet e qytetarëve dhe nëse nuk ka kohë që të qëndrojmë në mbledhje atëherë nuk është dashur që jetë kandidat për Kuvendarë dhe kishte me ardh dikush tjetër i cili ka kohë të qëndrojë. Prandaj i nderuari Kryesues po ju lusë që të hiqni këtë parim nuk bënë ashtu si ju që tentoni që ti tejkaloni propozimet po ju them publikisht.

Kryesuesi – Me kërkesë të shefit të grupit të PDK-së i cili ka propozuar që përgjigjet nga ana e Ekzekutivit të jepen në foltore të Kuvendit në mënyrë që të jenë të informuar të gjithë Kuvendarët me përgjigje, e qes në votim: Konstatohet se me shumicë të votave aprovohet propozimi i shefit të grupit të PDK-së. Kalojmë në pikën e radhës:

3. Shqyrtimi i Raportit 3 mujor financiar të vitit 2018.

Afrim Limani - Përsëritje për të gjithë të pranishmit, Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa prezantoi raportin 3 mujor për vitin 2018 para Kuvendarëve, ku i ceku të arriturat, ngecjet si dhe sfidat që i ka pasur kjo drejtori në këtë periudhë 3 mujore. Po ashtu drejtori ceku se realizimi i buxhetit për këtë periudhë ka qen në masën prej 23.51 %.

Shipe Kryeziu – Tek raporti i shpenzimeve sipas kategorive ekonomike dhe krahasimi i tyre për muajin janar-mars, tek kodi 13320 është një dallim shumë i madh, po ashtu edhe tek kodi 13330 është një dallim, tek kodi 13301, tek kodi 13509, po ashtu tek kodi 14024 u ceken mirëmbajtja e objekteve shëndetësore, cilat objekte shëndetësore sepse në vitin e kaluar nuk ka pasur fare këto shpenzime kurse në këtë 3 mujorë i kemi ma shumë se 15,000.00 €, tek kodi 14032 përsëri është vlere prej 15,712.00 €, tek kodi 14220 botimet publike nuk jam duke e kuptuar çka keni dashur të thoni me këtë 50.00 € ka qen vitin e kaluar, kurse tani është 2,700.00 €. Tek kodi 14230 shpenzime për informim publike, kodi 14310 dreka zyrtare, vitin e kaluar shuma ka qenë 1,559.00 €, kurse këtë vit edhe më e madhe 2,620.00 €. Kodi 14410 shpenzime sipas sipërfaqes së gjykatës, nuk e kam të qartë çfarë shpenzime janë këto.

Florije Boshnjaku – Së pari e përgëzoj Kryetarin e Komunës, Drejtorin e Financave që kanë arritur të ngrisin të ardhurat komunale, pra jemi pluse 8,178.00 € shpresoj se kjo rritje të vazhdoj edhe pse e di që do të ketë pak problem. Shqetësimi imë është që këto të hyra që janë të planifikuara nga ish qeveria Komunale dhe nga propozimi që ka ardhur nga Ministria për mua janë shqetësuese, sepse për vitin 2018 janë përcaktuar të hyrat mbi

1,800,000.00 € dhe kjo shumë nuk ka mundësi që të arrihet. Ajo që është më shqetësuese është se prapë do na vinë kufijtë buxhetor dhe sigurisht për vitin 2019 do i risin edhe më shumë, problemi është se si ne tani do veprojmë sepse kufijtë ritën kurse realizimi do të jetë vështirë i realizueshëm. Ndërsa sa i përket objekteve që janë me qira, mendoj se vitin e kaluar ka pasur të hyra vetanake për arsye të faljes së borxheve nga ana e Komunës, të gjitha ata që i kanë pasur objektet e Komunës me qira janë detyruar që vitin e kaluar një pjesë të borxhit ta paguajnë, nuk e di këtë vite a do të mundemi të arrijmë sikurse vitin e kaluar sepse këtë vite nuk e di a kemi ndonjë kërkesë për falje borxhi.

Vahid Krasniqi – Krahassimi i të hyrave për periudhën janar – mars, e falënderoj për prezantimin Drejtorin për Buxhet dhe Financa, jam duke parë po ashtu se është një diferencë e të hyrave prej 8,178.00 € dhe kjo është një gjë e mirë. Ajo që mua më brengos është çështja e shpenzimeve, jemi duke parë që në shumë kode ka ngritje të shpenzimeve, do të ndalem tek 3 kodet ku është i përfshirë pak edhe profesioni imë. Kodi 13950 regjistrimi i automjeteve në 3 mujorin e 2017 kemi shpenzime 570.00 € kurse në 3 mujorin e 2018 kemi shpenzime 605.00 €, a kemi rritje të numrit të veturave në Komunë sepse për regjistrim të një automjeti taksa rrugore është 40.00 €, kurse 25.00 € vazhdimi i sigurimit dhe 10.00 € taksa ekologjike, pse ka ndodhë rritja prej 35.00 € në këtë 3 mujor. Tek kodi 13151 sigurimi i automjeteve ku është një dallim nga 3 mujori i vitit të kaluar një shumë prej 477.00 € më shumë këtë vit, pra nëse kemi rritje të numrit të veturave është e kuptueshme, por nëse jo atëherë a kemi pasur vetura të aksidentuara ku kanë qenë fajtor të Komunës dhe me këtë rast është rritur sigurimi i veturave. Pastaj tek kodi 14010 mirëmbajtja dhe riparimi i veturave, ku është një dallim prej 14,789.00 € në krahasim me 3 mujorin e vitit të kaluar. Në bazë të përvojës që e kam e shohë se këtu është katërfishuar shuma e mirëmbajtjes së veturave gjë që për mua është shumë e pakuptueshme, por besoj se Drejtori do na shpjegoj se pse ka ardhur deri tek kjo shumë.

Mirjeta Krasniqi – Desha të ndërlihem tek faqja 11 kodi 13330 kemi një dallim të madh në shërbime postar nga 1,376.00 € që kanë qenë vitin 2017, tani janë 6,182.00 €, ku është një diferencë shumë e madhe, pse është ky dallim kaq i madh a janë borxhe të vjetra apo është bërë shpërndarja e tatimit në pronë përmes postës. Nëse është kjo e fundit ne në Komunë kemi zyrtar që ndonjë herë nuk janë shumë të angazhuar, besoj se ata kishin mundur të angazhohen që ti shpërndajnë këto fatura dhe në këtë mënyrë e kishim kursyer Komunën. Pastaj tek kodi 13480 shërbime për anëtarësim, dua ta di se çka nënkuptojmë me këtë shërbim.

Ali Morina – Drejtori i Financave qysh në mbledhjen e kaluar kur e kemi diskutuar raportin financiar për vitin e kaluar, ka deklaruar se raporti 3 mujor i vitit 2018 do të ketë fryrje për shkak të obligimeve. Ky raport paraqet të hyrat dhe shpenzimet në të gjitha dikasteret komunale, ku vlen të theksohet rritja e të hyrave të tatimit në pronë, prandaj ju përgëzoj për trendin e këtyre të rritjeve dhe uroj që ky trend të vazhdojë edhe në muajt në vazhdim. Kolegët parafolës i paraqiten vërejtjet e tyre tek disa kategori rreth shpenzimeve të tyre, po ashtu edhe unë i kam disa vërejtje në disa kategori. I nderuari Drejtor tek këto shifra të paraqitura sa është shpenzimi i mjeteve vetëm për periudhën 3 mujore të vitit 2018 dhe sa është pjesa e obligimeve, kishte me qenë mirë nëse e kishte paraqitur një shtyllë të veçantë pjesën e obligimeve dhe pjesën e shpenzimeve për këtë 3 mujor, me këtë rast kishim mundur ndoshta me e përcjellë edhe trendin e pagesave të obligimeve nga ana e Komunës.

Fehmi Cena – E kam lexuar me kujdes këtë raport, ky është një raport gjithëpërfshirës dhe për këtë e përgëzoj Drejtorin e Financave, kam edhe unë disa vërejtje dhe disa sqarime që do i kërkoj. Tek planifikimi dhe prej asaj që është realizuar kemi të hyrat pozitive në raporte me 3 mujorin e vitit 2017, por ajo që është realizuar në raport me planifikimin është një dallim goxha i madh 15.23% dhe nëse hynë edhe gjokat e trafikut 16.29% mundet të thuhet se nuk është premtuese sa duhet. Në faqe nr.5 të hyrat nga gjokat e trafikut kemi minus 2,500.00 € të hyra në raport me vitin 2017, është një paradoks për arsye se e keni dëgjuar se janë disa tarifa më të shtrenjta të komunikacionit kurse ne e shohim se të hyrat janë pagës më të vogla, por ndoshta kjo nuk e pasqyron një pasqyrë të saktë shpresoj se në raportin vjetor do të kemi shifra më të sakta. Tabela tjetër gjokat nga gjykata është zero, të hyrat nga pyjet zero, nuk e di pse është kjo nëse këto nuk hynë në kuadër të buxhetit atëherë pse është paraqitur ky pozicion. Në faqe nr.6 paraqitja sipas kodeve ekonomike jam duke parë se në disa kode ekonomike kemi më pak të hyra, si në shëndetësi kemi më pak të hyr në këtë 3 mujor në raport me vitin 2017, por ajo që më ka ra më

shumë në sy është qiraja nga objektet tregtare ku diku 50% ka më pak të hyra, po e përmendi këtë me qëllim sepse kemi informata se objektet që janë pronë e Komunës me qira disa nuk i paguajnë me qëllim, madje kemi raste kur dikush e ka uzurpuar një lokal dhe as vetë nuk punon dhe as nuk donë të larojë objektin, këto raste ndodhin në qytet. Në këtë tabelë kisha propozuar që ta ketë edhe një tabelë shtesë, p.sh planifikimi për shëndetësi jam duke parë se të hyrat janë më pak për 2,000.00 € në raport me vitin 2017, por sa ka qen planifikimi nuk kemi. Kur jemi tek të hyrat mendoj se dikasteret dhe Qeveria komunal duhet që të ketë kujdes që me të hyrat të jenë sa ma aktivë, për arsye se ato janë shumë të rëndësishme për Komunën sepse sa më shumë që arkëton Komuna të hyrat, mundet sigurisht që të bëjë planë për të ardhmen për realizim të projekteve të ndryshme që janë në interes të qytetareve si në infrastrukturë, shëndetësi, për barna esenciale, arsim, sporte dhe kulturë etj. Po e kërkoj një sqarim nga faqja nr. 9, tek shëndetësia shpenzimet kapitale janë më shumë se 84,000.00 €, mua më intereson ta di se ku është bërë ky investim kapital.

Rasim Fazliu – Fillimisht e falënderoj Drejtorin e Financave që na ka sjellë këtë raport, meqenëse është raporte 3 mujorë ne e dimë që viti i ka 12 muaj dhe plani vjetor i të hyrave ndahet në 4 periudha, nëse është kështu atëherë realizimi bije ashtu siç e ka cekur drejtori në shifrën prej 16.29%, kurse në fakte është dashur të jetë 25%. Pasi jam në dijeni për këto gjëra besoj se e gjitha varet prej periudhave se kur qytetarët i kryejnë obligimet e tyre. Ajo që desha të them është se nuk mundet të thuhet që është bërë realizimi i mirë për arsye se është 3 muji i parë dhe qytetarët ende nuk kanë filluar që ti kryejnë obligimet e veta. I dëgjova këtu me vëmendje disa koleg që e than se jemi të kënaqur se plani i të hyrave vetanake i Komunës është rritur, ne të gjithë i gëzohemi këtij fakti sepse ato mjete shkojnë në të mirën e mirëqenies qytetare të Komunës së Rahovecit. Nëse e bëjë një krahasim në bazë të planifikimit që ka qen për vitin paraprak 2017 dhe planifikimin e tanishëm për vitin 2018, do të shohim se në vitin 2017 ka pasur realizim më të madh 19,49%, kurse tani është 26.29%. Kurse sa i përket pikave të tjera nuk do i përsërisë sepse i ceken edhe kolegët e mi.

Afrim Limani – Do i përgjigjem me radhë pyetjeve, e nderuara znj. Shqipe Kryeziu i ka bërë disa pyetje, kërkoj falje nëse nuk do mundem të i përgjigjem të gjitha pyetjeve sepse nuk kam mundur të arrij të i shkruaj të gjitha. E nderuar sa për sqarim të gjitha këto shpenzime që janë bërë në kuadër të kësaj kategorie në masën prej 80% janë obligime të cilat i kemi bartë nga viti i kaluar, nuk është se ne nuk kemi bërë shpenzime por ato as që kanë qen në masën prej 20%. Për hire të korrektësisë ndaj kolegeve nuk kam dashur që ti barti borxhet për çdo 3 muji dhe të ceki se sa kemi bartë borxhe, në KPF kam thënë se obligimet do të barten çdo 6 muji dhe në fund të vitit në mënyrë që ju ta keni një pasqyrë të sakë se sa kemi bërë ne shpenzime dhe sa kemi bartur borxhe. E nderuara znj. Florije bëri pyetje lidhur me të hyrat mosrealizimi në raport me planifikimin, e nderuar edhe në KPF e din që e kemi diskutuar këtë temë, është një problem që ne realisht këtë shumë prej 1,600,000.00 € nuk do të mundemi me realizu, pse këtë e them, e them sepse ne e bëjmë gjithmonë planifikimin tonë të saktë të buxhetit me plus minus ndër vite, por nga ministria e financave marrim rekomandime që ne duhet që ta risim planifikimin e të hyrave për aq sa e caktojnë ata, mendoj se ne duhet të gjithë të angazhohemi që të i menaxhojmë këtë të hyra. Z. Vahid Krasniqi pyeti për dy kategoritë e shpenzimeve, të regjistrimit të automjeteve dhe sigurimin e automjeteve si dhe mirëmbajtja. Regjistrimi dhe sigurimi i automjeteve është një shumë fikse që dhe ndodhë 1 herë në vit, ka ndodhur që vitin e kaluar nuk është paguar një borxh dhe është bartur në këtë 3 mujorin e parë, figuron më shumë në 3 mujorin e parë por ju siguroj se në 6 mujorin do të jenë shpenzimet më të vogla. Sa i përket mirëmbajtjes së automjeteve keni të drejtë por edhe këtu ka shpenzime që i kemi bartur, këtyre shpenzimeve i kam dhënë edhe prioritet pasi kanë qen shpenzime të mëdha dhe për këtë ka figuruar si shumë pak më e theksuar se shumët e tjera. Znj. Mirjeta Krasniqi pyeti për shpenzimet postare, këto janë ato shpenzime të cilat i dedikohen shpërndarjes së faturave të tatimit në pronë, ne këtë vite e kemi nënshkruar po ashtu një kontratë në vlerë prej 7,000.00 €, por këto shpenzime që jeni duke i parë janë kryesisht shpenzime të bartura. Po ashtu pyetje ishte a mundemi ne vetë me i shpërnda faturat e tatimit në pronë, tani por edhe në mandatin e kaluar kam bërë disa analiza së bashku me kolegët e mijë që janë po ashtu ekspertë të kësaj fushe, por e kemi parë se më mirë është me e shpërnda me postë se sa ne vet sepse bëhet një kosto më e madhe sa se shërbimet që na ofron posta. Shpenzimet për anëtarësim janë ato shpenzime nëse ne kemi p.sh marrëveshje me një institucion ose organizatë tjetër, në rastin konkret janë

shpenzimet e AZHR-së si dhe Asociacioni i Komunave. I nderuari z. Fehmi Cena i bëri disa pyetje, e para planifikimi në kuadër të shëndetësisë kjo është një pyetje me vend, i nderuar Kuvendar në raportin e radhës do e kesh edhe planifikimin sipas drejtorive, nuk e kam futur për arsye se kam menduar që mos ta ngarkoj raportin. Pastaj pyetje e radhës ishte pse mungojnë gjërat nga gjykata, i nderuar gjërat e gjykatave sikurse vitin e kaluar edhe tani ende nuk na ka ardhur nga ministria e financave një raport, këto shpenzime nuk realizohen drejtpërsëdrejti nga ne. Pyetje tjetër ishte se ku janë bërë shpenzimet kapitale, besoj kjo që është për operatorin i cili është duke punuar objektet në qendrat mjekësore. Z. Rasim Fazliu e bërë një analizë të të hyrave të 3 mujorit të vitit 2017 dhe 3 mujorit të vitit 2018, i nderuari z. Rasim unë këtë nuk e thashë me krenari, por e thashë që është një diferencë pozitive në krahasim me vitin e kaluar, prapë e them realizimi i të hyrave në raporte me planifikimin është gënjë problem.

Kryetari – Besoj se në raportin 6 mujorë financiar do të precizohet saktë se cilat ishin obligimet që i kemi pranuar dhe cilat janë shpenzimet të cilat janë kryer gjatë kësaj faze, e di që ka shënimet e saktë drejtori por në raportin 3 mujorë nuk e ka paraparë që ti fusë këto shpenzime. Në raportin 6 mujorë financiar e ndjej si obligim që ti njoftoj anëtarët e Kuvendit të Komunës që ne nuk jemi në situatën më të mirë të mundshme me përmbaruesit, ne jemi duke paguar koston e gabimeve të qeverive tona bukur shtrenjtë. Nuk është marrë nëse e tregojmë që ne duhet të paguajmë diku 24,000.00 € për një gabim që është bërë në vitin 2009 dhe më duket se përmbaruesi vetëm se e ka marrë mjetet, ne jemi të detyruar punëtores së Komunës për 7 vite sa ajo nuk ka punuar të ja paguajmë pagën. Ne nuk jemi në situatën më të mirë të mundshme financiare sa i takon obligimeve po ashtu sa i takon kërcënimeve me përmbarues si institucione, Prandaj e them se do të përpiqemi që çdo tentim të jetë më koordinim të plotë me ligjin sepse për çdo gabim paguan qytetari ose taksa paguesi ynë. Nëse ne këto 24,000.00 € ja kishim ndarë 24 familje skamnore kishte me qenë shumë mirë, kurse tani i marrë vetëm një njeri i cili e ka realizuar të drejtën e vetë sipas ligjit. Nuk është çudi nëse do të ketë edhe lëndë të tjera sa i përket kësaj situatë, sot nuk do ju japë të gjitha informatat, kjo që po e them nuk është akuzë për ndonjë qeveri por është apel që të kemi kujdes sepse nëse është kështu ligji siç veprojnë këtë përmbarues atëherë ata shumë lehtë mund ta bankrotojnë ndonjë institucion kur bënë kësaj lloji gabime. Është e vërtetë se edhe unë nuk jam i kënaqur me atë që ka realizuar Komuna të hyrat pavarësisht këtij trendi pozitiv, po ashtu nuk jam i kënaqur as me të hyrat që realizohen nga objektet me qira, ne disponojmë një listë të borxhlinjëve jo të mirë, po ashtu ne disponojmë edhe një listë të subjekteve ku nuk i dihet se ku i kanë bërë bartjet, po kjo besoj se është më shumë puna e auditorit. Por sidoqoftë ne kemi një trend të hyrave të tatimit në pronë, kemi një trend të të hyrave nga qiratë, po ashtu me një të ardhëm të afërt me ndihmën e Kuvendarëve do të kemi rishikim të rregullores për taksa, tarifa, gjëra dhe ngarkesa në mënyrë që ti krijojmë lehtësira subjekteve tregtare, ekonomike si dhe bizneseve, pastaj të gjejmë së bashku modalitetet se si kishim mundur që ti risim të hyrat e Komunës sepse në këto pozicione ku jemi ne duke i mbledhur të hyrat vetanake është vështirë me e realizuar planin vjetor të të hyrave vetanake.

Rasim Fazliu – Falënderoj Kryetarin që i përmendi punën e gabimeve që janë bërë, është e vërtetë se aty ku punohet edhe gabohet, po ashtu ndoshta janë bërë me qëllime të mira por në fund dele gabim. Por pasi i përmende këto gabime është dashur të i përmendësh të gjitha sepse edhe më vonë kanë ndodhur këso gabime të kësaj natyre, ka qenë e nderuara znj. Fiknete Kasapi e cila është larguar pastaj ne kur kemi qenë në qeverisje jemi detyruar që të paguajmë dëmshpërblimin sepse e drejta ishte në anën e saj. Por sidoqoftë e thashë se është njerëzore të gabohet shpresojmë që herrave të tjera Kryetarët e Komunave të mos marrin qëndrime të gabuara dhe mos të shkojnë përtej e Komunës kot.

Kryetari – Ne kemi pasur edhe këso raste por shumat nuk kanë qenë kaq të mëdha, mua më vije keq tani që znj. Florije Boshnjaku nuk e ka shfrytëzuar të drejtën e saj që ti merr 24,000.00 € sepse edhe kjo ka mundur që nga viti 2009.. qëndrimi im është që të jemi të kujdesshëm në vendimmarrje dhe në respektim të procedurave sepse mundemi me ardhë deri tek kjo situatë me përmbarues, siç e dini e gjithë Kosova ka probleme me përmbarues, këta e kishin gjetur ilaçin një gabim më bë nuk po ta falshin asnjë minutë, prandaj duhet tani e tutje të jemi pak më të kujdesshëm.

Kryesuesi – Ju faleminderit për diskutimin rreth pikës së 3, kalojmë në pikën e radhës:

4. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të brendshëm për DKA-në.

Binak Kryeziu – Shef i auditimit të brendshëm – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, raporti i DKA-së është pjesë e planit vjetor të vitit 2017, fushëveprimi i auditimit ka qenë muaji shkurt i vitit 2017 kurse auditimi është kryer për vitin 2016, aktivitetet tona kreishtë kanë qenë në përcaktimin e objektivave dhe në verifikimin e zbatueshmërisë së rekomandimeve. Në këtë raport janë të përcaktuar 6 objektiva, objektivi kryesor ishte të hyrat dhe shpenzimet, gjatë këtyre të gjatuarve janë dhënë 4 rekomandime, 3 rekomandime janë zbatuar kurse 1 rekomandim pjesërisht.

Rasim Fazliu – Falënderoj z. Binak Kryeziun për raportin që na ka sjellë, por unë do e përdori një fjalë popullore që thuhet se ky raport është sikurse kofinin pas të vjelave kur shikon në vreshta kurse rrushi veç të sosë, prandaj po e them se auditori i brendshëm në Komunë e luan rolin e këshillëdhënësit për Kryetarin e Komunës dhe qeverinë Komunale, prandaj do të ishte mirë që këto raporte të na vijnë brenda aktualitetit e jo të na vije pas 3 viteve sepse nuk kanë kurrfarë efekti. Mendoj se kjo pikë që është sjellë është tamam humbje kohe sepse ne nuk kemi se çka me bë sa i përket kësaj, por do e lusja qeverinë aktuale që raportet e auditimit nëse dëshirojnë të na sjellin le të na sjellin me kohë, në mënyrë që edhe ne nëse mundemi do i ndihmojmë në këtë drejtim. Ne e dimë se auditori i Komunës nuk është i obliguar që të na raportoj neve por vetëm Kryetarit të Komunës, por pastaj Kryetari i Komunës është i obliguar që të na raportoj neve, kështu që kjo punë shkon në mënyrë reciproke.

Faton Ramadani – Përsëritet për të gjithë, desha po ashtu edhe unë që të ndërlidhem sa i përket këtij raporti të auditimit të brendshëm edhe pse e kam lexuar këtë raport por për mua kjo nuk është raport sepse është shumë i mangët. Në këtë raport është bërë auditimi vetëm i çerdhes së qytetit “Tulipanët” kurse nuk janë përfshirë punët dhe problemet e tjera të cilat e kanë përcjellë DKA-në në vitin 2016. Kishte me qenë mirë që herrave tjera kur të na sillet të jetë një raport më i kompletuar.

Flori Boshnjaku – Lidhur me këtë raport të auditimit i ceku edhe z. Rasim Fazliu, faktikisht dhe juridikisht auditori i brendshëm është bashkëpunëtori më i ngushtë i Kryetarit të Komunës, i cili i tregon Kryetarit se ku nuk ka punët mirë. Po ashtu plotësisht pajtohem me z. Faton Ramadinin, gjithashtu kur të bëhet auditimi të merret edhe rregullorja për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba dhe të parashihet se çka ka të planifikuar në DKA, pse nuk janë realizuar, pastaj pse nuk ka të hyra në shkollë kur janë regjistruar nxënësit, a kanë lëshuar dokumente gjatë vitit shkollor, pastaj a ka ndonjë shkollë të hyra që realizon nga qiraja, kështu kishte me na ndihmu neve ehe Kryetarit. E jo të futet vetëm çerdhja sepse në çerdhe paguhet 30.00 € për secilin që e qon fëmijën. Ka ardhur auditimi i auditorit të jashtëm dhe i kemi parë se cilat janë të metat e qeverisë, prandaj ky më nuk vlen.

Florida Bajraktari – Edhe unë e kam diskutimin pak a shumë të njëjtë sikurse shefi i grupit tonë, mendoj se ky raport nuk është dashur të vije sepse është shumë me vonësë, ky raport është dashur të vije me kohë në mënyrë që me pas çka të diskutojmë sot në mënyrë që të kemi mundësi të ndryshojmë ndonjë nga këto problemet e cekura në këtë raport.

Fahrije Lushi Morina – Edhe unë do të ndërlidhesha pothuajse njëjtë sikurse parafolësit e mijë, me çfarë rëndësie del ky raport i cili daton me një periudhë të shkuar dhe njerëzit kompetent mungojnë, së pari kjo duhet që të kihet parasysh, kishte me qenë mirë që të merremi me raporte pak më serioze sepse këtë raport e kam lexuar mirë dhe sipas meje për këtë raport nuk ka ndonjë arsye që të diskutohet. Po të ishte ky raport për këtë periudhë do të diskutonim mjaftë, por pasi nuk është nuk kemi çka të zgjasim sa i përket këtij raporti.

Munib Durguti – Pothuajse të gjitha ato që e kish ndërmend të i them janë cekur nga kolegët, siç e dini unë kam pas vërejtje edhe për raportin e auditorit për shëndetësi i cili ka qenë në mbledhjen e kaluar. Të nderuar vetëm nëse e analizojmë në aspektin logjik e kemi një raport të punës të cilin e nënshkruan Kryetari i Komunës dhe një raport të auditorit i cili vije nga zyra e Kryetarit, ne tani cilit duhet që ti besojmë, dhe me të vërtetë nëse e shikojmë raportin e vitit 2017 nuk përkon aspak me këtë raport të auditorit për të njëjtën periudhë, ngase këtu vetëm një segment e përfshin, në këtë raport shumëçka mungon. Auditorit aty ku i teket shkon dhe i merë disa mostra dhe del një raport i auditorit për në sektor. Ne jemi shumë të interesuar që të shohim raportin e auditorit të

jashtëm, kurse auditori i brendshëm detyrën kryesore e ka që të gjeturat e auditorit të jashtëm në bashkëpunim me grupet punuese brenda qeverisjes komunale të i adresoj në mënyrë që performanca të përmirësohet.

Dervish Çadraku – Edhe unë me shumicën e diskutimeve të parafolësve pajtohem, me të vërtetë ky është një raport i auditimit që ka ardhur krejt vonë dhe nëse e marrim që ta shqyrtojmë këtë raport na del që nuk jemi të fuqishëm që ta ndryshojmë këtë situatë. Nëse e bëjmë një krahasim të këtij auditimi dhe auditimin e kaluar për QKMF-në, pothuajse janë të njëjtat gabime që kanë ndodhur në atë raport janë duke ndodhur edhe në këtë raport. Me këtë dua të them se institucionet tona po kanë probleme gjithmonë kur kemi të bëjmë me paranë publike, është shumë e rëndësishme për qeverinë aktuale dhe nëse është e nevojshme së bashku me auditorin të shkojnë të evidentojnë gabimet të cilat edhe sot pas 3 viteve janë duke u përsëritur në këto institucione. Prandaj me këtë është mirë që të mirret më shumë qeveria aktuale e jo ne si Kuvend dhe mos të lënë të ndodhin jashtë komizave të gabimeve që janë duke ndodhur çdo ditë nëpër institucionet tona.

Fehmi Cena – Megjithatë unë e kam mendimin tim personal, sado që ky raport i takon të kaluarës dhe është i cunguar, prapë se prapë e ka rendësin e vetë sepse ne mësojmë diçka nga këto raporte, posaçërisht kur shikojmë se për vitin 2016 ka të gjetura mjaftë të pa rregullta, ku ceket se janë shkelur ligjet nuk janë respektuar ligjet, pastaj nuk janë respektuar rregulloret, kontratat, pikërisht nga menaxhmenti. Që është e vërteta ky raport i auditimit me të vërtetë më shumë i dedikohet çerdhes por unë besoj se kjo është sinonim edhe për qendrat e tjera. Ne e dimë se detyra kryesore e menaxhmentit edhe në institucione por edhe në nivel Komune është që të shikoj zbatueshmërinë e ligjeve dhe rregulloreve në fuqi, nëse ata nuk i kanë zbatuar atëherë çka presim nga vartësit e tyre, prandaj ne duke e shikuar të kaluarën mësojmë për të ardhmen. Tek çerdhja pikërisht e kam mendimin se në tabelë është dashur të përfshihet edhe shpenzimet nga paga, pra të kemi një pasqyrë të saktë për të hyrat, për pagat, për numrin e fëmijëve që janë në këtë çerdhe, numrin e punëtorëve, pastaj duhet që të shikohet edhe kostoja e efektivitetit të çerdhes, nëse ne mendojmë për të ardhmen që është kërkesa e qytetarëve për të hapur edhe çerdhe të tjera qoftë qytet apo fshatra duhet që të shikohet normal edhe kostoja e efektivitetit, po ta kishim ne në këtë raport do na shërbente si bazë për të ardhmen.

Kryetari – Të nderuar Kuvendar nuk është se jam i kënaqur unë me punën e njësisë së auditimit të brendshëm, po ju tregoj se ju kam dhënë edhe vërejtje me shkrim të dy auditorëve të brendshëm z. Binak Kryeziut dhe z. Ruzhdi Kabashit. Qëllimi i auditimit të brendshëm është ndihmesë e jashtëzakonshme e cilit do institucion, në mënyrë që të sigurohemi bashkërisht që të jemi në respekt të plotë për sa i takon ligjit dhe veprimet qeverisëse në nivel lokal ose nivel qendrorë të jenë të rregullta në pajtim me ligjin dhe këta auditor na ndihmojnë shumë. Të them të drejtën auditorët e komunave paguhen goxha mirë, të ju them të drejtën një diferencë shumë të vogël e ka shefi i njësisë së auditimit të brendshëm me pagën e Kryetarit të Komunës, por kërkoj nga auditorët e brendshëm që ta përcjellin punën tonë rregullisht, ta ndihmojnë punën tonë rregullisht dhe ju garantoj se çfarëdo raporti i auditorit si të jashtëm ashtu edhe të brendshëm është detyrë i secilës qeveri që ti lexojë me vëmendje të gjeturat, rekomandimet dhe të gjitha çështjet të cilat i adreson çoftë auditori i brendshëm apo i jashtëm në secilin dikaster. Ne i lexojmë këto raport dhe i kemi mundësitë që ti përmirësojmë gjithçka që varet prej veprimeve, prej planeve, prej synimeve që i ka një qeverisje. Ne tani shumë shpejtë e presim edhe raportin e auditorit të jashtëm për vitin 2017 dhe duke i lexuar me vëmendje veprimet e qeverisjes së kaluar duhet që të jemi të kujdesshëm që ti plotësojmë rekomandimet dhe ti adresojmë saktë të gjeturat në mënyrë që mos të përsëriten së paku disa gabime që janë përsëritur gati qe 20 vite, e ato janë regjistrimi i aseteve Komunale, ne duhet që të përpiqemi që kjo temë të largohet nga rendi i ditës dhe mos të ketë më probleme në këtë pik. Pastaj pasqyrat financiare ne kemi ende mundësi me i përmirësuar, kemi ende mundësi me e bërë kategorizimin e shpenzimeve të taksave komunale, kemi mundësi me e bërë po ashtu edhe plotë punë të tjera.

Kryesuesi – Ju faleminderit për diskutimin e bërë, kalojmë në pikën e radhës:

5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike – Stacioni i Autobusëve.

Kryetari – Ju e keni para vete një Propozim vendim ku tregon se çfarë rruge duhet të ndjekjet që të shkohet më tutje për çështjen të cilën e ka ngritur z. Rexhep Oruçi në takimin e kaluar, dhe ne kemi arritur që për këtë

mbledhje ta qesim si pikë të rendit të ditës në Kuvend, shpresojmë se do të ecim në drejtim të përmbylljes së suksesshme të një aseti jashtëzakonisht të rëndësishëm për Komunën e Rahovecit siç është stacioni i autobusëve. Ne e kemi propozuar një anëtar i cili duhet të jetë nga ana e ekzekutivit, e ai është Drejtori i Shërbimeve Publike z. Përparim Krasniqi si pjesë e grupit të dy anëtarëve të tjerë të cilët do i caktojë Kuvendi. Besoj se e dini dhe e keni të qartë që duhet që të plotësohet edhe kriteri gjinor, sepse nëse nuk plotësohet ky kriter atëherë vendimet do na kthehen mbrapa për rishqyrtim nga MAPL-ja.

Kryesuesi – Tani neve na nevojiten që ti bëni dy propozime nga anëtarët e Kuvendit, këto propozime i takojnë dy subjekteve më të mëdha politike e ato janë PDK-ja dhe AAK-ja së bashku me NISMËN.

Fehmi Cena – Ky mendim që e dhatë ju neve na duke se është pakëz i pa drejtë, për arsye se kandidati i kandiduar nga Kryetari i Komunës vije nga radhët e AAK-së, prandaj mendoj se nuk është e drejtë që dy vetë të jenë nga e njëjta parti kurse paritë e tjera mos të kenë kandidat, po ashtu ju kujtoj se LDK-ja i ka po ashtu aq kandidat sa i ka AAK-ja pa koalicion. Prandaj i nderuari Kryesues me e drejtë kishte me qenë që PDK-ja me propozu kandidatin e dytë kurse LDK-ja kandidatin e tretë.

Kryesuesi – I nderuar z. Cena nëse i referohemi si subjekte më të mëdha politike atëherë është AAK-ja së bashku me NISMËN të cilët i kanë 8 Kuvendarë dhe sipas kësaj logjike propozimi i takon AAK-së. Sa i takon z. Përparim Krasniqit ai i takon pjesës së ekzekutivit, por megjithatë ne e vlerësojmë mendimin e juaj.

Dervish Çadraku – Nuk e di atëherë pse jemi në këtu paritë e vogla, ky diskriminim që jeni duke na bërë neve është shumë i padrejtë, po ashtu unë nuk jam që paritë politike të i propozojnë kandidatet e tyre, por kishte me qenë mirë që ne vetë të propozojmë kënd dëshirojmë dhe le të zgjidhet ai i cili merr vota më shumë. Nuk është e drejtë kështu sepse qysh në start neve si parti të vogla na eliminoni, nëse dëshironi kështu atëherë nuk është dashur neve fare të na thërrisni vetëm për një votë. Po ashtu mundemi që të gjitha paritë që janë të përfaqësuara të propozojnë nga një kandidat dhe le të zgjidhet ai i cili merr vota më shumë.

Rexhep Oruqi - Kishte me qenë mirë që pas diskutimeve të i përafrojmë qëndrimet, pastaj pse bash 3 anëtarë pse nuk i bëjmë 5 anëtarë ku do të përfaqësoheshin të gjitha subjektet politike me nga një përfaqësues, po ashtu edhe për punë të funksionalitetet të grupit punues është më mirë që të jenë 5 anëtar sepse nëse janë 3 kandidat njëri mungon atëherë vendimmarrja do të vështirësohet, po ashtu duhet ta dini se ky komision do të ketë punë shumë.

Isak Hoti, shef i zyrës ligjore – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë, komfor ligjit 03L/087 për ndërmarrjet publike propozimin e z. Oruqi nuk lejohet për shkak se në nenin 5 të ushtrimit të të drejtave të aksionarëve thuhet decidivisht kështu: Kur një Komunë është aksionare në ndërmarrjen publike lokale të drejtat e saj aksionare do të ushtrohen nga një komision aksionar komunal i cili përbëhet nga një anëtar i emëruar nga Kryetari i Komunës dhe 2 anëtar të tjerë të emëruar nga Kuvendi Komunal, pra decidivisht përshkruhet me 3 Anëtarë e jo me 5.

Kryetari – Sa për qartësi, grupet më të vogla politike të mos ndihen të diskriminuara ne mundemi me bë propozime dhe ato propozime të aprovohen me shumicë votash. Të nderuar mos harroni se komisioni i aksionarëve përbëhet prej 3 anëtarëve kurse bordi do të përbëhet nga 5 anëtar dhe nga këtu po kërkoj që të përfshihet edhe VV sepse nuk është keq që të përfshihet edhe VV-ja. Për sa i takon shqetësimit që u ngritë nga këshilltari z. Fehmi Cena është shumë e natyrshme që ka grupe më të mëdha dhe më të vogla, për vete kisha pas dëshirë që të jemi grupi më i madh politik në Komunë por nuk jemi. Ju ftoj që ta formojmë këtë komision, po ashtu pajtohem plotësisht me atë që i tha z. Oruqi se ka mjaftë punë ky komision sepse ky stacion i autobusëve përveç që duhet të kalojë në pronësi të Komunës, këtij stacioni i nevojiten edhe transformime të tjera, ne si Komunë nuk guxojmë ta lëmë me këtë pamje si është sot.

Rasim Fazliu – Ne si grup i PDK-së për anëtar të Komisionit Komunal të aksionarëve nga Komuna e Rahovecit për ndërmarrjen Publike Lokale Stacioni i Autobusëve në Rahovec e propozojmë z. Rexhep Oruqin.

Ali Morina – Ne si anëtarë të këtij komisioni propozojmë znj. Fjolla Duraku, jo vetëm për të përmbushur kuotën gjinore por duke e vlerësuar si një vajzë ambicioze dhe duke e parë si të gatshme për të kontribuar në këtë komision.

Fehmi Cena – Ne LDK-ja për këtë komision propozojmë znj. Hanolora Hoti.

Kryesuesi – A ka edhe dikush nga partitë e tjera që të propozojë ndonjë emër, nëse jo atëherë vazhdojmë me procesin e votimit, votimi do të jetë i hapur me aklamacion. Shkojmë me radhë për secilin, e qes në votim kandidatin z. Rexhep Oruqi: Konstatohet se me 3 abstenime, 21 vota pro dhe asnjë kundër, është aprovuar që z. Rexhep Oruqi të jetë anëtar i Komisionit Komunal të aksionarëve për stacionin e autobusëve.

Kryetari – Një sqarim i nderuari z. Qeska janë 3 propozime dhe nëse dëshiron që të shohim rregulloren do ti kërkoj Kryesuesit të Kuvendit që ta zbatoj rregulloren edhe në votim që është bërë në piken e 2. Pyetjet dhe përgjigjet, e di se si është rregullorja sepse nuk është hera e parë që jam këtu. Ne jemi duke shkuar me votim të hapur dhe ai që merë vota më shumë është pjesë e Komisionit të aksionarëve. Ne dimë se është dashur me votim të fshihet por mos e komplikoni situatën, ne ju thamë qartë se vetëm dy duhet, por ishte kërkesa e LDK-së që të jenë 3 anëtar dhe ne u pajtuam, ka kësso praktika z. Qeska sepse kam parë kështu praktika edhe në Kuvend të Kosovës ne nuk kemi të drejtë të votojmë në pako sepse do të mbetet një kandidat jashtë, besoj se çdo gjë është në rregull le të fillojmë me kandidatin e dytë dhe të tretë i nderuari Kryesues.

Kryesuesi - E qes në votim Propozimin e dytë znj. Fjolla Duraku: Konstatohet se me 9 vota për, asnjë votë kundër dhe 18 abstenime është votuar znj. Fjolla Duraku. Kalojmë tek propozimi i 3 për znj. Hanolora Hoti: Konstatohet se me 15 vota për 8 kundër dhe 5 abstenime është aprovuar që znj. Hanolora Hoti të jetë anëtare e Komisionit Komunal të aksionarëve për stacionin e autobusëve. Pra anëtarë të Komisionit Komunal të aksionarëve për stacionin e autobusëve janë: z. Përparim Krasniqi, z. Rexhep Oruqi dhe znj. Hanolora Hoti. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi dhe aprovimi i dhënies së pronës së paluajtshme Komunale në shfrytëzim afatshkurtër personave fizik dhe juridik.

Kryetari – Ju para vetes e keni një propozim vendim për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës Komunale përkatësisht Qendrës grumbulluese për pemë dhe perime e cila gjendet në fshatin Xërxë. Besoj se jeni në dijeni për një storie e suksesi e cila ka filluar që nga viti 2012 e deri në ditët e sodit, Komuna jonë ka në këtë aset strategjik të vetin që është pronë Komunale, po ashtu edhe për parcelat për të cilat bëhet fjalë kontribut të veçantë. Ky është një partner serioz në arritjen e sukseseve të caktuar të qendrës grumbulluese për pemë dhe perime, kjo storie e suksesit nuk është kontribut vetëm e partneritetit e Komunës së Rahovecit dhe qendrës grumbulluese, por në këtë storie të suksesit kanë marrë pjesë edhe Komisioni Evropian, ka marrë pjesë edhe USAIDI, ka marrë pjesë edhe Kelmendi GMBH dhe shumë partner të tjerë në një mënyrë ose tjetër kanë krijuar disa lehtësira në atë që quhet lidhja e hallkave të bashkëpunimit prodhues dhe në bashkëpunim me kompanitë eksportuese prodhimet e Rahovecit, sidomos ato perimtare por edhe rrushi janë eksportuar dhe kanë pasur një plasman të suksesshëm edhe në tregun e Bashkimit Evropian. Besoj se tani jemi në situatën kur duhet që të filloj procedurën e shpalljes së ankandit, përkatësisht ky Kuvend ka formuar një Komision për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme dhe shpresoj se duke i përfillur të gjitha procedurat e mbështetura në ligj ne do të kemi mundësi që të sigurohemi bashkërisht që qendra grumbulluese për pemë dhe perime në Xërxë do të funksionoj mirë, do të ketë arritje të reja dhe Komuna e Rahovecit do të ketë impaktin e vetë drejtpërdrejt për të gjitha këto zhvillime të cilat janë në interes për fermerët e Komunës së Rahovecit. Aty për momentin kanë plotë gjëra si frigorifer, pajisjet e asaj fushe etj. Ju ftoj juve si anëtar të Kuvendit Komunal pa dallim që ti japim dritën jeshile përgatitjes për fillimin e procedurave të ankandit publik dhe procedurave të vlerësimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të kësaj prone Komunale.

Rasim Fazliu – Faleminderit që na keni ofruar këtë pikë, po ashtu edhe unë pajtohem me shumicën e fjalive që i tha Kryetari, vërtet kjo qendër grumbulluese brenda këtyre viteve 2012-2018 ka qenë storie e sukseseve, do të ishte shumë mirë nëse edhe bizneset e tjera të Komunës sonë ta ndjekin rrugën e kësaj qendre në mënyrë që të ecin punë mirë. Duke u bazuar në të dhënat që na keni ofruar këtu, shihet se kjo qendër ka treguar rezultate solide gjatë aktivitetit të vetë që nga viti 2012-2018, për këtë më së miri flasin shifrat që i kemi të gjithë para vete. Do e marr vetëm një shembull, në vitin 2017 kanë qenë të lidhura afro 600 kontrata, nëse shkojmë me logjikën që një fermer e mbanë një familje dhe nëse e marrim mesataren në një familje 5 anëtar, atëherë $5 \times 600 = 3000$, që i bije

se indirektë në këtë qendër grumbulluese ka ndikuar që të punësohen 3000 punëtor, prandaj kjo nuk duhet të lihet anash kurrësi. Përveç kësaj kjo qendër ka kontrata me industrinë përpunuese në Kosovë dhe jashtë saj, për punimin e produkteve perimore siç janë konservimet etj. është logjistikë e mirë për Drejtoritë e bujqësisë në nivel vendi edhe për Ministrinë e Bujqësisë edhe për Fakultetin e Bujqësisë në dhënien e shënimeve të sakta për varietetet e reja të cilat japin rendimente të mira për njësi të sipërfaqes. Për veç kësaj Qendra Grumbulluese në Xërxë ka impakte ekonomike në shumë lëmi siç janë: Industria e ambalazhimit, plehrave kimik, industria e plastikës, transportit etj. Mbi të gjitha kjo qendër ka eksportuar perime jashtë vendit dhe e ka sjellë valutën nga vendet e jashtme në vendin tonë. Komuna e Rahovecit edhe në kontratën e parë ka marrë obligime dhe me mjete nga Bashkësia Evropiane që të ndërtojë dhe zhvillojë këtë qendër grumbulluese, nëse ne nuk e përkrahim këtë qendër mundemi të penalizohemi dhe të i hedhim donacionet dhe asetet që gjenden në këtë qendër grumbulluese.

Ishte fjala se cilat janë ato asetet: si frigorifer me kapacitet 800 m³, linja për klasifikimin e perimeve, janë 6 tabela klasifikuese, një pionier i cili mbanë peshë deri në 1 tonelatë, shiriti për transportin e perimeve, një kamion për transportimin e pemëve dhe perimeve brenda dhe jashtë vendit. Prandaj në mënyrë shumë njerëzore ju kisha lutë të gjithëve që ta përkrahim këtë propozim të Kryetarit për këtë aset kaq të vlefshëm që e ka Komuna, dhe në të procedohet në ankandin publik ku është edhe komisioni i cili i çekë kushtet.

Refki Kryeziu – Sa i përket kësaj pike të rendit të ditës për dhënien e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme Komunale, në zonën kadastrale në fshatin Xërxë, në vendin e quajtur SKAJA, konsideroj se është interes i përgjithshëm publik për ruajtjen dhe grumbullimin e pemëve dhe perimeve të fermerëve të Komunës sonë. Andaj kërkoj nga kolegët e mijë Kuvendarë që ta përkrahin këtë pikë të rendit të ditës.

Fahrije Lushi Morina – Pasi konsiderohet si një pikë mjaftë e rëndësishme për grumbullimin e pemëve dhe perimeve duke falënderuar edhe donatorët gjithsesi, gjithnjë mendoj se çështjet e tilla si kjo nuk donë hezitim. Po ashtu kërkoj që të përkrahët kjo pikë nga të gjithë Kuvendarët, por kishte me qen mirë që të gjithë fermerët e Komunës sonë të kenë qasje të drejtë.

Ali Morina – I nderuari Kryesues ne si grupe i AAK-së dhe i NISMËS e mbështesim këtë propozim sepse një vendim i tillë do i ndihmonte shumë fermerët e Komunës sonë, kur dihet se ky objekt është i destinuar për pikë grumbulluese për pemë dhe perime, po ashtu inkurajoj operatorët të cilët do të operojnë në këtë veprimtari që të risin mbështetjen ndaj fermerëve me mjetet e punës dhe me sera si dhe me programe trajnimit me qëllim të përgatitjes sa më profesionale të fermerëve tanë.

Kryesuesi – E qes në votim pikën Propozimin për dhënien e pronës së paluajtshme Komunale në shfrytëzimin afatshkurtër personave fizik dhe juridik: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e 6 (gjashtë) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

7. Shqyrtimi dhe aprovimi i marrjes së vendimit për ndarjen e mjeteve për Festivalin Folklorik Kombëtar “Anadrinia Jehon” Dejnë.

Kryetari – Komuna e Rahovecit në vazhdimësi e ka mbështet një ngjarje të rëndësishme kulturore që ka marrë përmasa Kombëtare, ku marrin pjesë shumë shoqëri kulturo – artistike, Festivali “Anadrinia Jehon” është shumë i rëndësishëm në Komunën tonë. Tradita e Komunës së Rahovecit është krijuar për të mbështetur fuqimisht brenda mundësive të veta këtë festival, po ashtu është edhe një traditë e mbështetjes edhe nga Ministria e Kulturës, po ashtu ka interesim edhe nga donatorët të cilët kujdesen për mbarrëvajtjen e suksesshme të këtij edicioni ashtu siç janë kujdesur për edicionet e mëparshme. Në cilësinë e Kryetarit të Komunës së Rahovecit në bashkëpunim me Drejtorin për Kulturë, rini dhe sport e kemi krijuar këshillin organizues, ata janë në vllugun e përgatitjeve që edhe këtë vit të kryhet sa më me sukses festivali folklorik “Anadrinia Jehon”. Ndihma financiare e propozuar me vlerën 4,000.00 € është një ndihmë e domosdoshme së bashku me Ministrinë e Kulturës që na siguron deri diku do të kryhet me sukses dhe pa pasur nevojë që të hymë në obligime si Komunë ose si Këshill. Komuna i ka marrë masat që për çdo veprim të shpenzimit të taksave komunale në festivalin folklorik “Anadrinia Jehon” të kemi raporte të saktë, të qartë me shkrim për çfarëdo shpenzimi që krijohet, besoj se ky raporte kur ti vije radha do të vije në Kuvend, jo për faktin se ka ndodhë diçka në të kaluarën por vetëm duam që të sigurohemi. Të nderuar ju ftoj kush ka mundësi që me dt.11,12,13 të jemi në festival folklorik “Anadrinia Jehon”, po ashtu ju ftoj që ta

përkrahni këtë propozim vendim për mbështetje financiare në vlerën prej 4,000.00 € të festivalit folklorik “Anadrinia Jehon”.

Vahid Krasniqi – Para se të diskutoj për këtë çështje desha një sqarim të vogël, ekziston vetëm një OJQ Anadrinai Jehon, sepse për ndarje të subvencioneve duhet që të ketë një kërkesë, nëse është e njëjta OJQ që edhe herën e kaluar i ka fituar subvencionet prej 2,000.00 €, brenda viti nuk lejohet ndarja e subvencioneve të njëjtës OJQ, anë ka mundësi që të më jepni një sqarim.

Kryetari - Shoqata Kulturore “Anadrini” ka aplikuar në thirrjen për mbështetje të subvencioneve në DKRS, kjo shoqatë nuk është organizatore e festivalit, organizator i festivalit është këshilli organizativ në bashkëpunim të drejtpërdrejtë me DKRS-në dhe nën patronatin e Kryetarit të Komunës.

Mirjeta Krasniqi - festivali folklorik “Anadrinia Jehon” është një festival kombëtar i cili i bënë kultivimin e vlerave folklorike i cili çdo herë e më shumë është duke marrë përmasa më të mëdha, ku Komuna jonë përmes këtij festivali është duke u promovuar edhe jashtë kufijve tanë. Prandaj nëse ka mjete të mjaftueshme edhe ne jemi pro ndarjes së mjeteve financiare, por e gjitha që kërkoj është që kur të na sillet raporti i shpenzimeve në Kuvend, të ju bashkëngjiten edhe faturat e shpenzimeve në mënyrë që të shihet saktë se ku janë shpenzuar këto mjete, nëse paraja është e Komunës kishte me qen mirë që të ketë më shumë transparencë.

Rasim Fazliu – Ne si grupe i PDK-së e mbështesim propozimin e Kryetarit për ndarjen e mjeteve për festivalin folklorik kombëtar “Anadrinia Jehon”, po ashtu e mbështes propozimin e znj. Mirjeta sa i përket arsytimit të raportit të shpenzimeve.

Ali Zhuniqi – Pa dyshim që edhe ne e mbështesim iniciativa të këtilla, secili koleq deri më tani që bisedoi i tha fjalët me vend si karshi arsytimit të shpenzimeve dhe diskutimeve të tjera. Kam një pyetje për Drejtorin e Kulturës, rinis dhe sporteve: A ka Rahoveci si qytet ndonjë shoqëri Kulturo artistike që do na kishte përfaqësuar denjësisht në këtë festival.

Ali Morina – Ne si grupe i AAK-së e mbështesim plotësisht këtë propozim vendim.

Masar Popaj – Desha të diskutoj rreth tabelës së shpenzimeve që na është paraqitur, këtu ceket se ushqimi për grupe deri në 800 persona herë 3.00 € bëjnë 2,400.00 €, pra vlera mbi 55% po shkon tek ushqimi, a duhet patjetër që këta persona të hajjnë ushqim.

Kryetari – I nderuari z. Ali Zhuniqi mendova se do të thuash atë që desha të them e tha Kryetari i Komunës qysh në fillim, sepse unë e thash se me të vërtetë në raporte duhet që të jemi të kujdesshëm sepse auditorët zakonisht me OJQ na gjejnë probleme. Jam për një raport të detajuar përkitazi me të gjitha shpenzimet që bëhen, po ashtu desha të ji njoftoj se të gjitha raportet do ti keni në Kuvend. Çdo përfitues i parasë publike i cili ka marrë subvencione qoftë si OJQ ose si subjekt juridik ose ekonomik ai ka me pas për detyrë që ta sjellë raportin në Kuvend, sepse ne kemi marrë për obligim për hire të transparencës dhe llogari lënies me që të ju informojmë për çdo gjë që ndodhë në Komunën tonë. Sa i përket asaj që e ceku z. Masar Popaj për çështjen e ushqimit, i nderuar në këtë festival vijnë shoqëritë kulturo artistike nga Shkupi, Gjirokastra, vina nga viset jashtë Kosovës, prandaj ne e kemi për obligim që të ju krijojmë kushte për strehim dhe ushqim. Këtu nuk bëhet fjalë për shoqërinë kulturo artistike të fshatit Dejnë por bëhet fjalë për ata që na kanë ardhur nga jashtë Kosova dhe nga Komunitet e tjera të Kosovës.

Kryesuesi – E qes në votim Shqyrtimin dhe aprovimin e marrjes së vendimit për ndarjen e mjeteve për Festivalin Folklorik Kombëtar “Anadrinia Jehon” Dejnë: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e 7 (shtatë) e rendit të ditës. Ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhënë, mirupafshim në mbledhjet e radhës.

Mbledhja e kuvendit ka përfunduar në ora 14:00

Procesmbajtësi

Skender Hamza

